



**RAPORTI
VJETOR**



Raporti Vjetor

2020

- 4** Mesazh i Drejtorit të Përgjithshëm Ekzekutiv
- 6** Qeverisja e Korporatës
- 8** Strukturë Organizative
- 10** Burimet Njerëzore
- 14** Ecuria dhe Treguesit Kryesorë
- 16** Njësia e Operacioneve
- 18** Njësia e Kredisë
- 20** Njësia Bankare Retail
- 22** Përgjegjësia Sociale
- 28** Rrjeti i Degëve dhe ATM
- 30** Pasqyrat Financiare 2020
Raporti i Auditorit të Pavarur

Mesazh i Drejtorit të Përgjithshëm Ekzekutiv



Andi Balta

Drejtore i Përgjithshëm Ekzekutiv

Viti 2020 ka qenë një periudhë e jashtëzakonshme si nga ana financiare ashtu dhe ajo emocionale për punonjësit dhe klientët e ABI Bank. Një vit që filloi me një entuziazëm për rritjen domethënëse të turizmit në Shqipëri, në pak muaj e ktheu këtë industri në segmentin më të rrezikuar nga ana financiare. Veçanërisht pas ndikimit negativ të tërmetit të Nëntorit 2019, lajmi i pandemisë krijoi një ndjesi rrezikshmërie për të ardhmen e ekonomisë në Shqipëri.

ABI Bank ishte nga të parat institucione që tregoi maturi dhe largpamësi në përballimin e kësaj situatë të vështirë duke u bazuar në të dhënat e pandemisë në periudha të ndryshme kohore.

Puna disa vjecare, sukseset financiare dhe veçanërisht vendosja e kulturës së duhur të të bërit biznes, dhanë frytet e veta në këtë situatë jo të zakonshme. Ka qenë besimi dhe përkushtimi i punonjësve të ABI që përçuan qetësi dhe besim te klientët. Gjatë gjithë periudhës së parë të pandemisë mesazhi ynë te klientët depozitarë dhe huamarrës ishte që pandemia është tranzitore, ndërsa gatishmëria jonë për të mbështetur është e përhershme. Ky mesazh na dha mundësinë që të forcojmë marrëdhëniet ekzistuese si dhe të krijojmë marrëdhënie të reja. Siç keni qenë dëshmitarë, ne nuk patëm rradhë të gjata në degët e ABI dhe klientët u shërbyen në mënyrë shembullore si me ristrukturime të kredive ekzistuese ashtu dhe me kredi të reja. Këtu duhet të vlerësojmë kontributin

ABI Bank ishte nga të parat institucione që tregoi maturi dhe largpamësi në përballimin e kësaj situatë të vështirë duke u bazuar në të dhënat e pandemisë në periudha të ndryshme kohore.

e punonjësve në degë, drejtuesve të retail dhe korporatave për çdo kërkesë ristrukturimi, si dhe të Tranzit në menaxhimin e situatës së krijuar me profesionalizëm të theksuar. Gjithashtu, dua të falenderoj për punën e bërë të gjithë në zyrat qendrore për mundësimin dhe skedulimin e të punuarit në distancë, dezinfektimin e përditshëm dhe ruajtjen e mbarëvajtjes së punës gjatë gjithë periudhës së pandemisë.

Përveç sektorit privat, ABI mori dhe një rol udhëheqës në mbështetjen e bondit të qeverisë Shqiptare duke treguar një sjellje shembullore gjatë këtij procesi në një kohë të vështirë për të gjithë.

Së fundmi, ABI mbështeti direkt emergjencat mjekësore duke siguruar ventilatorë për sistemin shëndetësor dhe gjithashtu shpërndau ndihma direkt tek familjet në nevojë gjatë pandemisë.

Është e rëndësishme të rikujtojmë këto momente kyçe dhe të reflektojmë për arsyet e kalimit të pandemisë me sukses. Kultura e mrekullueshme e vendosur te ABI ka luajtur rolin kryesor. Kjo kulturë është bazuar në disa vite pune shumë serioze dhe gjithashtu në një pozicion shumë të shëndoshë likuiditeti, kapitali dhe thellësie profesionale në degë dhe në qendër.

Gjatë këtij viti ne pamë një harmonizim shumë të avancuar të aktivitetit të kredidhënies korporative me departamentet e ligjorit, risk dhe

përputhshmërisë. Nga ana tjetër, departamenti i thesarit dhe financës veprroi me shumë profesionalizëm në përdorimin e likuiditetit rezervë në bono thesari. Divizioni i retail mbështeti më shumë përkushtim rritjen e depozitave gjatë muajve Prill – Qershor, ndërkohë që gjithë personeli i zyrave qendrore vazhdoi të siguronte një përditësim të harmonisë operacionale dhe përmirësimit të ambjentëve të punës.

Si pasojë e gjithë këtyre veprimeve ABI shënoi një vit rekord në fitimin para taksës dhe totalin e aktiveve që raportuan respektivisht EUR 10.2 milionë dhe EUR 704 milionë.

Ndërkohë vlen të përmendet zgjerimi i aktivitetit të ABI në dy fusha të tjera, ABI INVEST dhe licënca për underwriting.

Ne kemi shumë plane për ABI INVEST dhe besojmë se në një periudhë afatmesme do të kthehet në një pikë referimi të këtij biznesi në Shqipëri. Pozicioni butik i ABI dhe eksperiencia e ekipit drejtues në tregje më të avancuara ndërkombëtare është një avantazh konkurrues dhe do japë mundësi të mrekullueshme për klientët ekzistues të ABI si dhe klientë të rinj për të diversifikuar portofolin e tyre si dhe për të rritur të ardhurat nga fondet e lira. Kjo është një mundësi unike e ABI Bank për të udhëhequr tregun e investimeve drejt një strategjie investimi afatgjatë dhe fitimprurëse.

Këshilli Drejtues

Kathryn Swintek

Kryetare e Këshillit Drejtues
(Anëtare e Pavarur)

Roberto Munoz

Anëtar i Këshillit Drejtues
(Anëtar i Pavarur)

Ernst Schlauch

Anëtar i Këshillit Drejtues
(Anëtar i Pavarur)

Kristin Giantris

Anëtar i Këshillit Drejtues
(Anëtare e Pavarur)

Armand Muharremi

Anëtar i Këshillit Drejtues
(Drejtor i Divizionit të Financës)

Brunilda Papa

Anëtare e Këshillit Drejtues
(Drejtoreshë e Njësisë së Operacioneve)

Andi Ballta

Anëtar i Këshillit Drejtues
(Drejtor Ekzekutiv i Përgjithshëm)

Banka Amerikane e Investimeve SHA ka miratuar Kodin e Qeverisjes së Korporatës i cili është në përputhje me Statutin e Bankës dhe legjislacionin në fuqi. Kjo rregullore përfshin rregullat e brendshme të Bankës, parimet dhe mekanizmat e kontrollit në bazë të të cilave Banka organizohet dhe menaxhohet, duke miratuar një strukturë e cila është transparente për investitorët, duke njohur dhe respektuar të drejtat e klientëve dhe duke siguruar interesat legjitime të aksionarit të vetëm të Bankës. Principet bazë të Kodit të Bankës mbi Qeverisjen e Korporatës përshkruhen në vijim:

1.1. Të drejtat e aksionarit

Banka ka vendosur rregulla që garantojnë për aksionarin, marrjen e informacionit të plotë mbi kushtet financiare të Bankës, si dhe mbi vendimet e Menaxhimit që ndikojnë ndjeshëm në veprimtarinë e saj. Aksionari i vetëm është një organ vendimmarrës i cili ushtron autoritetet e tij në përputhje me Statutin e Bankës, Kodin e Qeverisjes së Korporatave dhe dispozitat ligjore në fuqi.

1.2. Përbërja e Këshillit Drejtues

Këshilli Drejtues përbëhet nga shtatë anëtarë ekzekutivë dhe jo ekzekutivë (të pavarur), në për-

puthje me kërkesat e Ligjit për Bankat në Shqipëri. Diversiteti në arsim, përvojë dhe në fushat e ekspertizës së anëtarëve të Këshillit Drejtues është një faktor kyç në drejtimin e një banke Boutique.


1.3. Detyrat e Këshillit Drejtues

Këshilli Drejtues, është një organ vendimmarrës, i cili i përgjigjet drejtpërdrejtë aksionarit të vetëm. Këshilli Drejtues në përputhje me Statutin e Bankës dhe Kodin e Qeverisjes së Korporatave përcakton vizionin, misionin dhe strategjinë e Bankës. Qëllimi kryesor i Këshillit Drejtues është të sigurojë veprimtari të shëndetshme të kompanisë, duke ndjekur rritjen afatgjatë të vlerës ekonomike të saj, duke monitoruar, drejtuar dhe kontrolluar ekzekutivin në përputhje me interesat e Aksionarit.

1.4. Kontrolli i Brendshëm

Banka ka një divizion të organizuar të Kontrollit të Brendshëm, i mbikëqyrtur nga Komiteti i Kontrollit të Bankës. Ky i fundit, në përputhje me kërkesat ligjore, përbëhet nga tre anëtarë të pavarur, ekspertiza dhe monitorimi i të cilëve është një ndihmë e vlefshme dhe e vazhdueshme për Bankën. Kryetari i Komitetit të Kontrollit është njëkohësisht anëtar i Këshillit Drejtues.

Struktura Organizative





Burimet Njerëzore



Punonjësit janë shumë të rëndësishëm

Në ABI Bank, prioritet dhe element kyç i suksesit dhe në fokus të menaxhimit janë punonjësit, mbështetja, trajnimi, zhvillimi dhe vlerësimi i tyre.

Vetë qëllimi i punës në Divizionin e Burimeve Njerëzore është krijimi dhe ruajtja e një ambjenti punë tërheqës dhe profesionalisht stimulues.

Si gjithmonë, stafi vijon të jetë pika jonë më e fortë. Vecanërisht gjatë vitit 2020, ku situata nuk ka qenë aspak e zakonshme, punonjësit tanë kanë treguar aftësi dhe përpjekje të forta për të përmbushur standardet dhe objektivat e përcaktuara si dhe për të realizuar në kohë e me sukses objektivat e Bankës.

Gjithashtu, politikat e bankës për punësim dhe trajtim në mënyrë të barabartë, i kanë mundësuar 59 punonjësve të gjejnë punë afatgjatë apo afatshkurtër, brenda institucionit tonë, duke siguruar procese rekrutimi të suksesshme.

Pavarësisht situatës së shkaktuar nga pandemia Covid 19, gjatë vitit 2020, në ABI Bank kanë filluar punë 20% më shumë punonjës dhe janë larguar 53% më pak, krahasuar me një vit më parë. Edhe pse në kushtet e distancimit fizik, të gjitha proceset e rekrutimit janë zhvilluar normalisht, në funksion të përzgjedhjes të kandidatit më të mirë të mundshëm, me qëllim final rritjen cilësore të kapaciteteve të Burimeve Njerëzore.

Menaxhimi i situatës si pasojë e pandemisë

Gjatë vitit 2020, Divizioni i Burimeve Njerëzore ka luajtur rolin e një aktori kryesor në menaxhimin e situatës si pasojë e pandemisë, si një situatë emergjente e burimeve njerëzore. Si aktor kryesor i grupit të menaxhimit të krizave, në fokus kanë qënë kryesisht propozimet, ndjekja dhe monitorimi i Planeve të detajuara të punës lidhur me menaxhimin e situatës, hartimin e publikimin e Protokollit të brendshëm për Raportimin e rasteve COVID 19, Protokollit të masave që duhen marrë nga institucioni në rast eventit si dhe një plan të detajuar të masave higjieno-sanitare.

Në mënyrë të vazhdueshme janë dërguar te i gjithë stafi, udhëzime bazuar në direktivat e OBSH, Komitetit Teknik, Ministrisë së Shëndetësisë, Komitetit të Burimeve Njerëzore të Shoqatës së Bankave, në lidhje me masat dhe kujdesin personal që duhet të tregojë cdo punonjës.

Janë menaxhuar Planet Remote dhe Prezenca në punë e stafit, lejet vjetore në kushte pandemie. Janë monitoruar ngushtësisht dhe ndjekur vazhdimisht të gjitha situatat apo problematikat e raportuara nga stafi, duke patur një fokus e kujdes të vecantë për grupet me vulnerabël (koleget shtatzëna, apo me sëmundje kronike).

Divizioni i Burimeve Njerëzore ka qënë në kontakt të vazhdueshëm dhe është kujdesur për mbarëvajtjen e situatës shëndetësore të kolegëve të prekur

nga Covid19.

Gjatë inspektimit specifik të BSH për menaxhimin e situatës së pandemisë, nuk u identifikua asnjë gjetje, rekomandim apo sugjerim për menaxhimin e elementeve të sipërshënuar.

Situata e vitit 2020 ka qënë delikate për të gjithë ne, por vështirësia e shkaktuar nga një situatë e panjohur nuk është refkletuar në punën e përditshme dhe Divizioni i Burimeve Njerëzore është përpjekur të mos shtojë presion e të lehtësojë procese e raportime si dhe të japë mbështetjen e kontributin e saj në suport të stafit, sa herë ka qënë e nevojshme.

Një tjetër proces i rëndësishëm, sa impenjativ aq edhe sfidues nisur nga situata e krijuar për shkak të pandemisë ishte edhe organizimi, zhvillimi dhe monitorimi i trajnimeve për stafin.

Pas identifikimit të kërkesave të biznesit e nevojave të stafit për trajnim janë propozuar trajnime në përmbushje të këtyre nevojave. Edhe pse në një situatë tejet të vështirë, janë organizuar dhe koordinuar trajnime të jashtme dhe të brendshme (më së shumti online në respekt të protokolleve të sigurisë dhe rregullave në fuqi), duke bërë të mundur sjelljen e një produkti final cilësor dhe brenda standarteve të kerkuara, detyrimeve ligjore apo rekomandimeve të lëna.

Respektimi i diversitetit & të dhënat e fundit të BOD për gender



Banka Amerikane e Investimeve i jep mundësi të barabarta të gjithë kandidatëve dhe punonjësve pavarësisht nga mosha, gjinia, gjendja martesore, shtatzënia, statusi familjar, aftësia e kufizuar, raca, kombësia ose feja.

Divizioni i Burimeve Njerëzore, brenda fushës së tij të veprimit dhe kontrollit, garanton një angazhim maksimal në trajtimin në mënyrë të drejtë dhe të barabartë të individëve duke mos lejuar diskriminimin në asnjë moment gjatë të gjitha fazave të punësimit në ABI.

Banka Amerikane e Investimeve është një ndër të vetmet banka në sistemin bankar, bordin e së cilës e drejton një anëtare femër.

Gjithashtu, koleget femra përbëjnë 69% të forcës punëtore të ABI Bank dhe 73% përsa i takon linjës së parë të menaxhimit.

Ecuria dhe treguesit kryesorë

Viti 2020 u karakterizua nga sfida dhe pasiguri të lidhura me tërmetin e Nëntorit 2019 si dhe Pandeminë e Covid-19. Kultura "boutique" e bankës ndihmoi ndjeshëm në përshtatjen e shpejtë dhe të suksesshme me realitetin dhe rreziqet e krijuara nga këto ngjarje. Dinamika e biznesit gjatë vitit 2020 u konturua nga puna për arritjen e objektivave zhvillimore të bankës si dhe nismat e Qeverisë Shqiptare dhe politikat mbështetëse rregullative e monetare të Bankës së Shqipërisë për të lehtësuar pasojat e Pandemisë. Banka, ndjeshëm përtej objektivave fillestare të saj, arriti rritjen më të lartë historike të portofolit të kredisë. Në të njëjtën kohë u arritën objektivat në rritjen e depozitave të klientëve dhe investimet financiare. Nga ana tjetër, optimizimi operacional i arritur gjatë 2019 dha efekt maksimal në vitin 2020. Banka raportoi ulje domethënëse të shpenzimeve administrative duke arritur si rezultante të elementëve të mësipërm rritje mbi 100% të të ardhurave operative për vitin 2020 krahasimisht me 2019.

Kështu, ABI raportoi për vitin 2020 fitimin më të lartë historik duke tejkaluar nivelin prej EUR 10 milionë të fitimit neto para taksave.

Raporti i Mjaftueshmërisë së Kapitalit (RMK) dhe Norma e Likuiditetit më 31 dhjetor 2020 raportojnë përkatësisht pothuajse 21% dhe 80% duke përfaqësuar nga nivelet më të larta të kapitalizimi dhe normën më të lartë të likuiditetit në sistemin bankar.

INDIKATORËT KRYESORË	2020 (EUR MILIONË)	VS. 2019
Aktivet totale	704	↑ +10.4%
Depozita totale	551	↑ +3.3%
Kredia neto	237	↑ +16.4%
Investimet në Letra me vlerë	284	↑ +8.7%
Kapitali	83	↑ +5.3%
Fitimi neto pas taksave	8.6	↑ +41%
Renditja sipas asetëve totale	Nr. 6	↑ +1



Njësia e Operacioneve

Në këtë vit sfidues, Njësia e Operacioneve ishte shtylla ku u mbështet çdo funksion dhe proces që siguroi funksionimin optimal të Bankës që ofroi shërbim të plotë dhe në lockdown të përgjithshëm të pranverës 2020.

Njësia e Operacioneve arriti të përmbushë me sukses sipas parashikimeve projektet e nisur në 2019, si dhe të nisë e të përfundojë projekte të rëndësishme veçantë e shumë të vyer për klientët tanë të sfiduar nga pandemia/gjendja e jashtëzakonshme.

Njësia e Operacioneve përfundoi me sukses projektin e Ndryshimit të Personalizimit dhe Proçesorit të Kartave, tek partnerët aktual Euronet dhe Paylink. Ky ndryshim u siguron shërbime dhe produkte më të mira klientëve, më të shpejtë, të sigurtë e më eficientë. Kartat me logon ABI funksionojnë pa kontakt, dhe me siguri 3D standard bashkëkohor. Proçeset administruese të produkteve karta, u

përmirësuan duke u automatizuar, dhe duke aplikuar vendimmarrjen dhe segregimin e nevojshëm për cilësi dhe minimizim të riskut operacional.

Gjatë vitit 2020 u lançua projekti i upgrade të platformës online dhe zgjerimit me kanal in e ri digjital të Mobile Banking. Këto projekte kanë siguruar rritjes të cilësisë së shërbimeve ekzistuese, por edhe implementimin apo krijimin e një baze për shërbime të reja për klientët, në përputhje me kërkesat e tregut.

Për Divizionin e Teknologjisë së Informacionit dhe Departamentin e Sigurisë së Informacionit, ashtu si për gjithë njësitë e bankës, dhe më gjerë, për gjithë sistemin bankar, adaptimi në kushtet e pandemisë dhe distancimit social ishte sfida primare që u adresua në zbatim të motos "Work From Home". Brenda një kohe të shkurtër u vlerësuan rreziqet e Sigurisë së Informacionit që lidhen me implementimin e zg-

Sfida e 2020 – Pandemia

jdhjes "Work From Home" u ngrit një infrastrukturë e sigurtë për Remote Work, bazuar në teknologjinë CISCO, u sugjeruan dhe implementuan masat e duhura të sigurisë bazuar në praktikën më të mirë në nivel global, duke siguruar punën nga shtëpia të personelit të bankës me të njëjtat facilitete sikurse nga posti i tyre në ambientet e bankës në një infrastrukturë të sigurt dhe efikase.

Konsideruar risqet në këtë kuadër por edhe fokusin permanent të drejtimit të bankës për sigurinë e informacionit, krahas zgjerimit dhe përmirësimit të vazhdueshëm të infrastrukturës IT, banka planifikoi dhe implementoi investime të shtuara për sistemet e sigurisë së informacionit dhe monitorimit.

Projekti për Upgrade të Sistemit Qendror Bankar (Oracle – Flexcube) u iniciua gjatë vitit 2020, me pjesëmarrjen e të gjithë njësisë biznes dhe operacionale në një proces të gjërë për përgatit-

jen e kërkesave për përmirësim të proçeseve dhe funksionaliteteve në këtë version të ri. Projekti është duke vijuar gjatë 2021 dhe planifikon kalimin Live në fillim të vitit të ardhshëm.

U rishikua dhe u përshtat plani i vazhdimësisë së biznesit për të siguruar vazhdimësinë e proçeseve Bankare gjatë gjendjes së jashtëzakonshme të pandemisë.

Gjatë vitit 2020, Departamenti i Sigurisë së Informacionit mbajti në nivele të larta monitorimin ndaj incidenteve kibernetike duke u fokusuar në praktikën e evoluara të përdorura nga sulmuesit kibernetikë. Gjithashtu të gjithë punonjësit u trajnuan mbi çështje të sigurisë së informacionit përfshirë rreziqet e reja kibernetike. Operimi i suksesshëm, korrekt, i sigurtë e pa probleme i bankës remote, me gjithë partnerët dhe sistemet interface, vijon të jetë objektivi ynë i përditshëm.

Njësia e Kredisë

Në ABI Bank, kreditimi i sektorit privat të bizneseve u zgjerua kënaqshëm gjatë vitit 2020 duke marrë parasysh situatën e vështirë pandemike. ABI Bank ndoqi një strategji në mbështetje afatgjatë të të gjithë klientëve e sidomos të bizneseve që u prekën më shumë gjatë periudhës së pandemisë, kryesisht të përqendruar si në riskedulimin e kredive afatmesëm dhe afatgjata ashtu edhe në mbështetje të tyre me financime të reja, duke i qëndruar pranë bizneseve-klientëve të bankës dhe rritur shanset e mbijetesës së tyre.

Pavarësisht kufizimeve në sektorë të ndryshëm të ekonomisë, gjatë periudhës së pandemisë, të cilat ndikuan edhe në standardet e zhvillimit normal të bizneseve, në ABI Bank kreditimi i bizneseve nuk mungoi në asnjë periudhë të vitit. Rritja e kredisë u mbështet pjesërisht edhe nga skemat e garancisë sovraane të Qeverisë Shqiptare, por veçanërisht nga stabiliteti dhe likuiditeti i ABI Bank. Kredia në monedhën vendase ishte një faktor kryesor i zgjerimit të kredisë gjatë vitit 2020.

ABI Bank po bëhet gjithmonë e më tepër një partner i besueshëm dhe burim kryesor dhe i rëndësishëm i financimit për bizneset (shoqëritë e mëdha, të mesme e të vogla) në sektorin publik e privat, duke ofruar një sërë produktesh dhe shërbimesh nga kredi afatshkurtra për kapital qarkullues deri në kredi afatgjata për investime. Fokusi ynë për të qenë gjithnjë në krah të rritjes dhe konsolidimit në


treg të klientëve si dhe në suport të sukseseve të tyre, ka bërë të mundur që ABI Bank të ketë pothuajse 5% të tregut të kredive për vitin 2020. ABI Bank ka qënë një ndër bankat kryesore në treg me rritje të konsiderueshme në kreditimin e bizneseve, për të dytin vit rradhazi me pothuajse mbi 20% cdo vit, duke financuar klientët tanë ekzistues si dhe dhjetra klientë të tjerë të rinj cdo vit.

ABI Bank krenohet me ndërtimin e marrëdhënieve të ngushta dhe afatgjata me klientët e saj duke patur fokus kryesor të qenurit një Bankë Butik me qëllim përmbushjen e kërkesave të veçanta të klientëve.


Gjatë vitit 2020, janë disbursuar mbi Euro 70 milionë në 90 kompani, Korporata dhe SME, duke i financuar për kapital qarkullues si dhe duke i mbështetur në investimet e reja, në të gjitha industritë dhe fushat e biznesit.

ABI Bank ndjek me rigorozitet përzgjedhjen e investimeve të duhura në përputhje me politikat tona të riskut dhe mbrojtjen e kapitalit të bankës. Proçesi i aprovimit të kredive kalon në disa departamente të rëndësishme të bankës, si risku, ligjori, vlerësuesit, të detajuar dhe shumë strikt. Analiza e detajuar e sektorëve, kompanive dhe kërkesave të tyre për financim, na mundëson të investojmë në kompani dhe projekte me cilësi të lartë dhe që mund të përballojë cikle të ndryshme ekonomike.

Kredi të reja 2019



Kredi të reja 2020





Njësia Bankare Retail

Përballja me pandeminë e ktheu aktivitetin e Retail në një sfidë unike. Ne zgjodhëm të mbështesim klientët, u adaptuam menjëherë me kushtet e pazakonta dhe arritëm jo vetëm të plotësojmë nevojat aktuale, por edhe të mirëmbajmë marrëdhënien afatgjatë me ta. Mënyra tradicionale e të bërit biznes dhe komunikimi direkt u kufizua. U gjendën dhe u përdorën me sukses rrugë alternative duke sinkronizuar punën në zyrë me punën nga shtëpia, pa krijuar asnjë vonesë apo ndërprerje në mbështetje të aktivitetit bankar.

Retail krijoi një skuadër të vecantë me detyrë kryesore njohjen me kërkesat dhe nevojat e klientëve, veçanërisht të kredimarrësve që u ndikuan financiarisht nga "masat shtrënguese". Në zbatim të udhëzimeve të Bankës së Shqipërisë, Banka u tregua e gatshme të analizojë dhe pranojë kërkesat për shtyrje të pagesave të detyrimeve deri në 6 muaj. Proçesi, në tërësi, rezultoi i suksesshëm dhe pasi kaloi "frika" nga e panjohura, një pjesë e klientëve iu rikthyen shpejt, me zgjedhjen e tyre, pagesave normale.

Dalja nga vala e parë e pandemisë u shoqërua me një aktivizim të kërkesës për kredi individuale dhe biznese të vogla. U tejkaluan "barrierat" e masave shtrënguese dhe forca shitëse mundësoi plotësimin e informacionit duke aplikuar vizita të shpeshta klienti, për të shmangur trafikun në degë. Pavarësisht kushteve të pazakonta, në pjesën e dytë të vitit arritëm ti kthehemi normalitetit në kredidhënie.

Në valën e parë të pandemisë, Retail prezantoi një produkt –risi në depozita. Fushata u komunikua në mënyrë eficiente me e-mail dhe telefonata të personalizuar, jo vetëm për të sqaruar karakteristikat e produktit por edhe për të siguruar një shërbim në degë me orare specifike, duke shmangur rradhat dhe mbipopullimin. Vlen të përmendet që, në saj të produkteve atraktive dhe organizimit eficient të proçesit, aktiviteti i mbledhjes së depozitave, rezultoi i qëndrueshëm dhe i suksesshëm përgjatë gjithë 2020-ës.

Përgjegjësia Sociale

Banka Amerikane e Investimeve e konsideron Përgjegjësinë Sociale të Korporatës, si një pjesë të rëndësishme të kulturës korporative, duke ofruar një angazhim të vazhdueshëm në programe sociale, shëndetësore, nisma për mbrojtjen mjedisore, që kanë si qëllim zhvillimin e qëndrueshëm dhe përmirësimin e cilësisë së jetës së komunitetit ku kryejmë aktivitetin e biznesit tonë.

Gjatë vitit 2020, me fillimin e pandemisë COVID-19 në Shqipëri, ne kemi dëshmuar se jemi një biznes i përgjegjshëm duke i kushtuar një kujdes të veçantë komuniteteve dhe grupeve në nevojë. Periudha e karantinimit vuri në vështirësi jo pak

familje, në kushte të varfërisë ekstreme të cilat u gjendën të papërgatitura për të përballuar mungesat e krijuara. ABI Bank i është përgjigjur me përgjegjësi dhe ndjeshmëri të lartë, në plotësimin e nevojave jetike duke ofruar mbi 4 ton produkte ushqimore.

Në situatën emergjente, ku për jetët njerëzore një aparat respiratorë siguronte mbijetesë, Banka Amerikane e Investimeve vuri në dispozicion të Ministrisë së Shëndetësisë, tre pajisje respiratore për terapi intensive, si edhe materiale mbrojtëse për personelin shëndetësor të nevojshme në ato ditë të vështira.



Objektivi

1



Eliminimi i varfërisë në të gjitha format.



ABI Bank mbështet familjet e prekura nga fenomeni i gjakmarrjes në qytetin e Shkodrës

Në prag të festave të fundvitit, Banka Amerikane e Investimeve i ka kushtuar një vëmendje të veçantë familjeve të prekura nga fenomeni i gjakmarrjes në qytetin e Shkodrës. Në bashkëpunim me Fondacionin "Jo Gjakmarrjes Po Jetës", janë dhuruar paketa ushqimore për dhjetra familje në kushte të vështira ekonomike, si edhe veshje të ngrohta dimërore për fëmijët e këtyre familjeve.



ABI Bank dhuron paketa ushqimore për Kryqin e Kuq Shqiptar, Bashkinë Kamëz, Bashkinë Selenicë dhe Shoqatën për Integrimin e Pensionistëve në Shqipëri

Banka Amerikane e Investimeve gjatë muajve Prill-Korrik, në vijim të përpjekjeve për të zbutur situatën e krijuar nga Covid-19 u është gjendur pranë komuniteteve dhe grupeve në nevojë. Periudha e karantinimit ka vënë në vështirësi jo pak familje, të cilat janë gjendur të papërgatitura për të përballuar mungesat e krijuara. Ne i jemi përgjigjur kërkesave të Kryqit të Kuq Shqiptar, Bashkisë Kamëz, Bashkisë Selenicë, Njësi Administrative Kotë dhe Armen, si edhe Shoqatës për Integrimin e Pensionistëve të Shqipërisë, në dhurimin e mbi 700 paketave ushqimore për familjet shqiptare në nevojë dhe pensionistët e vetmuar në kushte të varfërisë ekstreme në Tiranë, Vorë, Kamëz dhe Paskuqan.



Objektivi

2



Zero Uri




ABI Bank dhuron 3.2 ton produkte ushqimore për Kryqin e Kuq Shqiptar, Food Bank dhe Down Syndrome Albania

Banka Amerikane e Investimeve ka dhuruar 3.2 ton produkte ushqimore për familjet shqiptare në nevojë. Ndihamat janë dërguar në rrethinat e Tiranës nga Kryqi i Kuq Shqiptar familjeve që kanë me banim të përhershëm persona me Aftësi të Kufizuara në qytetin e Shkodrës dhe rrethin e Matit nga Down Syndrome Albania dhe gjithashtu organizata partnere të Food Bank Albania si Qendra Sociale të Bashkisë Tiranë, Caritas Shqipëri dhe qendra OAZ që u japin ndihmë familjeve të pastreha dhe në kushte të vështira ekonomike.

ABI Bank mbështet qendrën "TISS" në Tiranë

Në 10 Tetor Ditën Botërore të Shëndetit Mendor, Banka Amerikane e Investimeve i ka kushtuar një rëndësi të veçantë kujdesit ndaj shëndetit mendor të fëmijëve, si pjesë të prioriteteve të përgjegjësisë sociale të saj, duke mbështetur qendrën "TISS" në Tiranë – Qendrën e Shërbimeve dhe Trajtimit Psiko – Social për fëmijë të moshës 1-12 vjeç. Projekti synoi fuqizimin e shërbimeve terapeutike, nëpërmjet pajisjeve me materiale didaktike dhe elektronike, si mekanizma të rëndësishëm për rezultate pozitive në zhvillimin psikologjik të fëmijëve.



ABI Bank dhuron respiratorë për shëndetësinë shqiptare

Banka Amerikane e Investimeve dhuroi në 24 Prill tre pajisje respiratore për terapi intensive, të cilat i shkojnë në ndihmë sistemit shëndetësor për të rritur kapacitetet e tij në përballjen me situatën e krijuar nga COVID-19. Ky dhurim i ABI Bank, vjen në vazhdimësi të një angazhimi të përhershëm në mbështetje të projekteve dhe nismave që shkojnë në ndihmë të komunitetit. Ndiha që ofrohet këto ditë të vështira për sistemin shëndetësor, konsiderohet nga Banka Amerikane e Investimeve si një detyrim për një biznes që beson dhe mbart vlerat e një biznesi të përgjegjshëm në raport me shoqërinë e komunitetin në shërbim të të cilit është.



Objektivi 4

Arsim Cilësor

Abi – Fakulteti Ekonomik, marrëveshje bashkëpunimi për praktika mësimore

Banka Amerikane e Investimeve nënshkroi në 27 Shkurt, një marrëveshje bashkëpunimi me Fakultetin e Ekonomisë, duke i dhënë rrugë kështu një ndërveprimi të dobishëm e të ndërsjelltë. ABI ofron mundësi për programe internship-i/ praktika mësimore për studentët e Fakultetit të Ekonomisë në Universitetin e Tiranës. Ceremonia e nënshkrimit të marrëveshjes u organizua pranë ambienteve të Fakultetit Ekonomik. Marrëveshja mes dy institucioneve u nënshkrua nga Drejtori i Përgjithshëm i Bankës Amerikane të Investimeve z. Andi Ballta dhe Dekani i Fakultetit të Ekonomisë z.Dhori Kule.




Objektivi 3

Shëndet i mirë dhe mirëqënie

ABI Bank mbështet në qytetin e Durrësit Spitalin Rajonal dhe Qendrën Shëndetësore Nr. 4

Banka Amerikane e Investimeve në kuadër të situatës emergjente të krijuar, dhe në respektim të masave për t'u ndërmarrë për mos përhapjen dhe mbrojtjen nga Covid-19 mbështeti Spitalin Rajonal të Durrësit dhe Qendrën Shëndetësore Nr.4 me materiale dhe veshje mbrojtëse për personelin shëndetësor. ABI Bank beson se solidariteti, ndjeshmëria sociale dhe optimizmi, janë çelësi për kapërcimin e çdo situatë sado sfiduese të jetë ajo.



Së bashku për Fjongon Rozë

ABI Bank mbështet për të katërtin vit radhazi fushatën e YWCA Albania nën moton "Fjongoja rozë më kujton", për të rritur ndërgjegjësimin e popullatës së përgjithshme për zbulimin e hershëm të kancerit të gjirit. Risi e fushatës për këtë vit, ishte puna lobuese për hapjen e Qendrës për Mbështetje Psiko-Sociale për gratë e diagnostikuara dhe familjet e tyre. Në datën 23 Tetor, ABI Bank si sponsor platin, i është bashkuar ecjes simbolike të organizuar në qytetin e Elbasanit.

Stafi i bankës i bashkohet nismës vullnetare të "dhurimit të gjakut"

Banka Amerikane e Investimeve, në datën 13 Nëntor, në bashkëpunim me Kryqin e Kuq Shqiptar, ndërmori nismën vullnetare të "Dhurimit të Gjakut", në mbështetje të fëmijëve që vuajnë nga Talasemia. Këtë vit për shkak të situatës së pandemisë, rezervat e gjakut pësuan një rënie të ndjeshme. Stafi i bankës me shumë përgjegjshmëri, nisur nga nevoja dhe misioni human, mbështeti këtë kauzë jetike, duke dhënë një kontribut në përmirësimin e këtyre rezervave.

Banka Amerikane e Investimeve me qëllim promovimin e barazisë gjinore dhe përmirësimin e kushteve të jetesës si pjesë të prioriteteve të përgjegjësisë sociale të saj, ka mbështetur:



Qendra "Vatra" në Vlorë

Në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të Gruas, qendra "Vatra" në qytetin e Vlorës ndërmori aktivitetin publik sensibilizues për të përcjellë mesazhin "T" i japim fund dhunës dhe shfrytëzimit të grave dhe vajzave", për të cilin u prodhuan dhe u shpërndanë materiale sensibilizuese me qëllim promovimin e barazisë gjinore dhe dhënien e mesazheve kundër dhunës dhe shfrytëzimit. Gjithashtu, u shpërndanë fletëpalosje me informacion dhe numra kontakti për të raportuar dhunën në familje dhe shfrytëzimin e grave dhe vajzave.

Objektivi 5

Barazi Gjinore



Forumi i Gruas Elbasan

Forumit të Gruas Elbasan i është ofruar mbështetje në shërbimin e saj primar, "Strehëzën e Emergjencës" për gratë dhe vajzat viktime të dhunës në familje, për të ofruar kushte më të favorshme jetese në mjediset e strehëzës. Mbështetja është ofruar edhe për 5 raste të grave të dhunuara së bashku me fëmijët, në mbulimin e shpenzimeve të pagesës së qirasë së banesës dhe paketave ushqimore për 5 muaj, deri në periudhën e riintegrit të tyre.



Organizata "Të Ndryshëm dhe të Barabartë" – strehëza për riintegrimin e viktimave të trafikimit dhe qendrat e kujdesjes ditore për fëmijët e tyre në Tiranë dhe Shkodër.

Projekti synoi përmirësimin e mjedisve fizike duke bërë të mundur që e gjithë pjesa e mobilimit dhe pajisjeve të amortizuara ndër vite, të zëvendësohej me të tjera të reja tepër funksionale dhe komode, për të garantuar një cilësi shërbimi më të mirë dhe kushte më të mira të jetesës.

"Dritare" podcast


Banka Amerikane e Investimeve mbështet për të dytin vit radhazi, serinë e Podcasteve "Shqiptarët e Mrekullueshëm", një bashkëpunim i ABI Bank dhe Rudina Xhunga, që sjell histori suksesi të shqiptarëve brenda dhe jashtë vendit.

ABI mbështet "Klubin Sportiv Studenti"

Banka Amerikane e Investimeve për të katërtin vit radhazi mbështet Klubin Sportiv "Studenti". Një nga bashkëpunimet më të suksesshme të ABI Bank. Së bashku për një të ardhme të shëndetshme!

ABI sponsor i përgjithshëm i TKOBAP

Banka Amerikane e Investimeve, një mbështetëse besnike e artit dhe vlerave kulturore të Shqipërisë, këtë herë, si sponsor i përgjithshëm i Teatrit të Operas, Baletit dhe Ansambllit Popullor. Një mbështetje që vijoi edhe përgjatë periudhës së vështirë të pandemisë duke u qenë pranë artistëve e duke mundësuar vazhdimësi të shfaqjeve me krijimtarinë më të mirë të repertorit shqiptar për të gjithë artdashësit. ABI ka mbështetur gjatë kësaj periudhe edhe rinovimin e ambjenteve të brendshme, si dhe investime në infrastrukturën artistike. Banka Amerikane e Investimeve do të vijojë të jetë sponsor i përgjithshëm i TKOBAP edhe përgjatë vitit 2022.



Art, Sport, Kulturë

ABI në koncertin "Thesarët e shpirtit"

"Thesarët e Shpirtit", në dt. 1 shkurt në Teatrin Andon Zako Çajupi në Korçë. Një mbrëmje nën tingujt e violinës, pianos, poezisë dhe baletit, në ndërthurje me muzikën e Bach, Chopen dhe talentit të artistëve shqiptarë e italianë. Mbështetur nga ABI Bank!

"Shqipëria në Art" e autorit Ferid Hurdhi

Enciklopedia: "Shqipëria në Art" e autorit Ferid Hurdhi, paraqitet si një enciklopedi e kujtesës figurative për historinë, kulturën dhe trashëgiminë kombëtare. Enciklopedia sjell një histori të shkurtër të artit shqiptar, Shqipërinë nëpërmjet artistëve të huaj e nëpërmjet artistëve shqiptarë. Banka Amerikane e Investimeve, si një mbështetëse besnike e artit, financoi publikimin e kësaj vepre dinjitoze, e cila tashmë është në duart e publikut shqiptar

abi

AMERICAN BANK
OF INVESTMENTS

investo në optimizëm

www.abi.al

Rrjeti i Degëve

Rrjeti i ATM-ve



QYTETI	EMRI I DEGES	ADRESA
Berat	Dega Berat	Blv. Kryesor, Lagjja 28 Nëntori
Durrës	Dega Durrës	Lagjja Nr.11, Rruga Dëshmorët, pallati i ri në Sheshin Pranvera
Elbasan	Dega Elbasan	Lagjja Luigj Gurakuqi, Rr. "11 nëntori", Godina 38/1
Fier	Dega Fier	Lagjja "Konferenca e Pezës", Sheshi Fitorja
Gjirokastrë	Dega Gjirokastrë	Lagjja "18 Shtatori"
Kavajë	Dega Kavaje	Bulevardi Kryesor, Lagjja nr. 3
Korçë	Dega Korçë	Rr. "Sotir Gura", Nr.1, Lagjja 2
Lezhë	Dega Lezhë	Blv. "Gjergj Fishta", Sheshi Qendror, përballë Hotel Liss
Lushnjë	Dega Lushnjë	Shëtitorja Kongresi i Lushnjes (pranë Postës Shqiptare)
Pogradec	Dega Pogradec	Rr. "Rreshit Çollaku", (përballë Hotel Turizmit)
Sarandë	Dega Sarandë	L. 1, Rr "Skenderbeu", Nr. 50, (pranë Kishës Ortodokse)
Shkodër	Dega Shkodër	L. "Vasil Shanto". Rr. 13 Dhjetori, Nr. 270
Tiranë	Dega Qendrore	"Rruga e Kavajës", Nd.27 H.1, Njësia Bashkiake Nr.10, Kodi Postar 1001
Tiranë	Dega "Samos Tower"	Rr. "Ismail Qemali", Nd.20 H.3, Njësia Bashkiake Nr.5, Kodi Postar 1019
Tiranë	Dega "Bajram Curri"	Blv. "Bajram Curri", përballë Nishrakut, Zona Kadastrale 8260
Tiranë	Dega "Qendra Pajtoni"	Autostrada Tiranë - Durrës, km 1, Godina "Pajtoni Business Center"
Tiranë	Dega "Komuna e Parisit"	Rr. "Medar Shtylla", Nd.49,H 13, Njesia Bashkiake Nr. 5, Kodi Postar 1019
Tiranë	Dega "Rruga e Dibres"	Rr. Dibrës, Kompleksi Halili, përballë Vila Gold
Tiranë	Dega "Sheshi Shtraus"	Rr. Qemal Stafa, Sheshi Straus
Tiranë	Dega "21 dhjetori"	Rr. "Frosina Plaku", Nr.2
Vlorë	Dega Vlorë	Blv. "Ismail Qemali", Parku Rinia

QYTETI	EMRI I ATM	ADRESA
Berat	Dega Berat	Blv. Kryesor, Lagjja 28 Nëntori
Durrës	Dega Durrës	Lagjja Nr.11, Rruga Dëshmorët, pallati i ri në Sheshin Pranvera
Durrës	ATM "Blv. Dyrrah"	Bulevardi kryesor "Dyrrah"
Durrës	ATM "Spitali rajonal"	Spitali Rajonal Durrës, Rr. "Aleksandër Goga"
Durrës	ATM "Shkozet"	Lagjja 14, Rr. "Tirana", Shkozet
Elbasan	Dega Elbasan	Lagjja Luigj Gurakuqi, Rr. "11 nëntori", Godina 38/1
Fier	Dega Fier	Lagjja "Konferenca e Pezës", Sheshi Fitorja
Gjirokastrë	Dega Gjirokastrë	Lagjja "18 Shtatori"
Kavajë	Dega Kavajë	Bulevardi Kryesor, Lagjja nr. 3
Kavaje	ATM "Luz i vogël"	Fshati Luz i vogël, pranë Komunës
Korce	Dega Korce	Rr. "Sotir Gura", Nr.1, Lagjja 2
Korce	ATM "Voskopojë"	Fshati Voskopojë, Qendër
Lezhe	Dega Lezhe	Blv. "Gjergj Fishta", Sheshi Qendror, përballë Hotel Liss
Lezhe	ATM Shengjin	Kompleksi Rafaelo, Shengjin
Lushnje	Dega Lushnje	Shëtitorja Kongresi i Lushnjes (pranë Postës Shqiptare)
Pogradec	Dega Pogradec	Rr. "Rreshit Çollaku", (përballë Hotel Turizmit)
Sarande	Dega Sarande	L. 1, Rr "Skenderbeu", Nr. 50, (pranë Kishës Ortodokse)
Shkoder	Dega Shkoder	L. "Vasil Shanto". Rr. 13 Dhjetori, Nr. 270
Tiranë	Dega Qendrore	"Rruga e Kavajës", Nd.27 H.1, Njësia Bashkiake Nr.10, Kodi Postar 1001
Tiranë	Dega "Samos Tower"	Rr. "Ismail Qemali", Nd.20 H.3, Njësia Bashkiake Nr.5, Kodi Postar 1019
Tiranë	Dega "Bajram Curri"	Blv. "Bajram Curri", përballë Nishrakut, Zona Kadastrale 8260
Tiranë	Dega "Qendra Pajtoni"	Autostrada Tiranë - Durrës, km 1, Godina "Pajtoni Business Center"
Tiranë	Dega "Komuna e Parisit"	Rr. "Medar Shtylla", Nd.49,H 13, Njesia Bashkiake Nr. 5,
Tiranë	Dega "Rruga e Dibres"	Rr. Dibrës, Kompleksi Halili, përballë Vila Gold
Tiranë	Dega "Sheshi Shtraus"	Rr. Qemal Stafa, Sheshi Straus
Tiranë	Dega "21 dhjetori"	Rr. "Frosina Plaku", Nr.2
Tiranë	ATM "Kombinat"	Rr Llazi Miho
Tiranë	ATM "Sky Tower"	Rr. "Ibrahim Rugova", Nr.5, Njësia Bashkiake Nr. 5, Kodi Postar 1019
Vlorë	Dega Vlorë	Blv. "Ismail Qemali", Parku Rinia
Vlorë	ATM "Riviera"	Blv. "Ismail Qemali", L. Pavarësia (pranë QTU Riviera)



BANKA AMERIKANE E INVESTIMEVE

**Pasqyra Financiare të veçanta më dhe për
vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020**

(me raportin e audituesit të pavarur bashkëlidhur)

PËRMBAJTJA

RAPORTI I AUDITUESVE TË PAVARUR	32-34
PASQYRA E VEÇANTË E POZICIONIT FINANCIAR	35
PASQYRA E VEÇANTË E FITIMIT TË HUMBJEVE DHE TË ARDHURAVE TË TJERA GJITHËPËRFSHIRËSE	36
PASQYRA E VEÇANTË E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL	37
PASQYRA E VEÇANTË E FLUKSEVE MONETARE	38
INFORMACION I PËRGJITHSHËM	39
BAZAT E PËRGATITJES	39-41
NDRYSHIMET NE POLITIKAT	41-43
PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE KRYESORE KONTABËL	44-58
MANAXHIMI I RREZIKUT	59-83
PËRMBLEDHJE E VLERËSIMEVE DHE GJYKIMEVE KONTABËL	83-85
VLERA E DREJTË E AKTIVEVE DHE DETYRIMEVE FINANCIARE	86-87
ANALIZA E AKTIVEVE DHE DETYRIMEVE SIPAS MATURITETIT TË MBETUR	88
MJETET MONETARE DHE TË NGJASME ME TO	89
HUA DHE PARADHËNIE BANKARE	89
INVESTIME FINANCIARE NË LETRA ME VLERË	90-92
HUATË DHE PARADHËNIET DHËNË KLIENTËVE	93-101
QIRA FINANCIARE	102
AKTIVE AFATGJATA MATERIALE DHE E DREJTA E PËRDORIMIT TË AKTIVEVE	103
AKTIVE AFATGJATA JO-MATERIALE	104
INVENTARI DHE AKTIVE TË TJERA	104
AKTIVE TË VLEFSHME PËR SHITJE	105
INVESTIME NË PJSËMARRJE DHE FILIALE	105
DETYRIME NDAJ BANKAVE	105-106
DETYRIME NDAJ KLIENTËVE	106
BORXHI I VARUR	107
AKTIVE DHE DETYRIME TATIMORE TË SHTYRA	107
PROVIZIONE PËR RREZIQE DHE SHPENZIME NETO	107
DETYRIME TË TJERA	108
KAPITALI AKSIONAR	108
REZERVAT	108-109
TË ARDHURA NGA INTERESAT, NETO	109
TË ARDHURAT NGA TARIFAT DHE KOMISIONET, NETO	110
TË ARDHURA TË TJERA, NETO	110
SHPENZIMET PERSONELI	110
SHPENZIME TË TJERA ADMINISTRATIVE	111
TATIM FITIMI	111-112
ANGAZHIME DHE DETYRIMET E KUSHTËZUARA	112
ÇËSHTJE LIGJORE	112
ANGAZHIMET PËR QIRATË DHE SHPENZIMET PËR QIRATË OPERATIVE	112
TRANSAKSIONET E PALËVE TË LIDHUR	113-115
NGJARJE PAS DATËS SË BILANCIT	116

Grant Thornton BSHG
 Nr. San. Ershen Korçesë T. D. Sh. B.
 Floor 1, 1000
 Ershen, Albania

T: 355 44 525 880
 M: +355 69 4714 731
 www.grantthornton.al
 contact@gt.al

Raporti i Audituesit të Pavarur

Për aksionarin e "Banka Amerikane e Investimeve sh.a".

Opinion

Në kemi audituar pasqyrat financiare të veçanta të "Banka Amerikane e Investimeve sh.a". (këtu e me pashte referuar "Banka"), të cilat përfshijnë pasqyrën e veçantë të pozicionit financiar më 31 dhjetor 2020, pasqyrën e veçantë të fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirë, pasqyrën e veçantë të ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e veçantë të flukseve të parase për vitin që mbyllet me këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të prelinkave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare të veçanta hashkëlëhbur paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Bankës më 31 dhjetor 2020, dhe performancën financiare dhe flukse të parase për vitin që mbyllet në këtë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

Bazat për Opinimin

Në v kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-te). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepet *Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare*. Ne jemi të pavarur nga Banka në përputhje me Kodin e Etikës të Kontabilistëve Profesionistë të njohur nga Bordi Ndërkombëtar i Standardeve të Etikës për Kontabilistët (IESBA), kërkesat e cila që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri, si dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me kodin IESBA. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshprehshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

Cështje të tjera

Pasqyrat financiare të veçanta të Bankës për vitin e mbylltur më 31 dhjetor 2019 u audituan nga një auditues tjetër i cili shprehu një opinion pa rezervë mbi ato pasqyra financiare më 21 gusht 2020.

(Informacione të tjera të përfshira në Raportin Vjetor për vitin 2020 të Bankës Amerikane e Investimeve sh.a.

Informacionet e tjera përfshijnë informacionet që jepen në Raportin Vjetor të Bankës për vitin 2020, i përgatitur në përputhje me nenet 17 dhe 19 të Ligjit Nr. 25/2018 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare", por këto informacione nuk përfshijnë pasqyrat financiare dhe raportin tonë të auditimit mbi këto pasqyra. Drejtimi është përgjegjës për informacionin e tjerë Raportit Vjetor të Bankës për vitin 2020 pritet të vëhet në dispozicion për dhe pas dates së raportit të këtyre audituesit. Opionimi ynë mbi pasqyrat financiare nuk mbulon informacione të tjera dhe në mënyrë të shprehur konkluzionet që japin siguri lidhur me këto informacione.

Në lidhje me auditimin e pasqyrave financiare, ne kemi përgjegjësitë të lexojmë informacionet e tjera të identifikuar më lart kur ato bëhen të disponueshme dhe të vlerësojmë nëse këtu informacione kanë mosperputhje materiale me pasqyrat financiare apo me kuptueshmërinë që kemi marrë gjatë auditimit ose në rast se përmbajnë gabime materiale.

Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverjen në lidhje me Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me SNRF-te, dhe për ato kontrole të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Bankës për të vazhduar në vijimësi, duke dhënë informacionin, nëse është e zbatueshme, për çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë dhe duke përdorur parimin kontabël të vijimësisë përveç në rastin kur drejtimi synon të likuidojë Bankën ose të ndërpresë aktivitetet, ose nëse nuk ka alternative tjetër reale përveç sa me sipër.

Ata që janë të ngarkuar me qeverjen janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Bankës.

Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare

Ç'është tona tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare të terësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lejojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston.

Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e një auditimi në përputhje me SNA-te, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticismin profesional gjatë procesit të auditimit. Në përfshirje:

- identifikojmë dhe vlerësojmë rreziket e anomaliave materiale në pasqyrat financiare, për shkak të gabimeve ose mashtrimeve, projektujmë dhe zhatojmë procedurë auditimi të cilat u përgjigjen këtyre rreziqeve, si edhe marrim evidencë auditimi të plotë dhe të mjaftueshme për të krijuar bazat e opinionit tonë. Rreziku i moszbulimit të një gabimi material që vjen si rezultat i një mashtrimi, është më i lartë se ai që vjen nga një gabim, pasi mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, mosveprimet të qëllimshme, keqinterpretime, ose shkelje të kontrolleve të brendshme

- marrim një kuptueshmëri të kontrollit të brendshëm në lidhje me auditimin, për të planifikuar procedurën të përshtatshme në varësi të rrethanave, dhe jo për të shprehur një opinionim mbi efektshmërinë e kontroleve të brendshme të entitetit.
- vlerësojmë konformitetin e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve kontabël dhe informacioneve shpjeguese të bëra nga drejtimi.
- konkludojmë mbi përdorimin e duhur të parimit kontabël të vëmendisë nga drejtimi si dhe, bazuar në evidencat e marra gjatë auditimit, konkludojmë nëse ekziston një pasigurë materiale e lidhur me ngjarjet ose kushte të cilat mund të sjellin dyshime në aftësinë e entitetit për të vazhduar në vijuesi. Nëse konkludojmë që ekziston një pasigurë materiale, ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin tonë të auditimit për informacionet shpjeguese përkatëse në pasqyrat financiare ose, nëse këto informacione shpjeguese janë të pamjaftueshme, të modifikojmë opinionimin tonë. Përfundimet tona janë të bazuara në evidencat e auditimit të marra deri në ditën e raportit tonë të auditimit. Megjithatë, ngjarjet ose kushtet e ardhshme mund të jenë shkak që entiteti të ndalojë së vazhduari në vijuesi.
- vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë dhënien e informacioneve shpjeguese, dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet haze në mënyrë të saktë që të arrijnë një prezantim të drejtë.

Në komunikojmë me atë të cilët janë të ngarkuar me qeverisjen, mdis vështrës të tjerë, për qëllimin dhe kohën e planifikuar të auditimit, gjetjet e rëndësishme gjatë auditimit, përfshirë çdo mangësi të theksuar në kontrollin e brendshëm të cilat ne i identifikojmë gjatë procesit të auditimit.

Grant Thornton sh.p.k.

Tiranë, Shqipëri
30 mars 2021

Klodian Kodra, FCA



BANKA AMERIKANE E INVESTIMEVE SH.A.

PASQYRA E VEÇANTË E POZICIONIT FINANCIAR

Më 31 dhjetor 2020

(Të gjitha shumat janë në mijë Lekë, përveçse kur shprehet ndryshe)

Banka përcakton modelin e saj të biznesit, në nivelin që reflekton më mirë mënyrën se si menaxhon grupet e aktiveve financiare për të arritur objektivin e saj të biznesit. Modeli i biznesit i Bankës nuk vlerësohet bazuar në instrumente individuale, por në portofole të grupuara. Vlerësimi i modelit të biznesit bazohet në skenarë të pritshëm, pa marrë në konsideratë skenarët në "rastin e stresit". Nëse fluksat e mjeteve monetare pas njohjes fillestare realizohen në një mënyrë të ndryshme nga pritshmëritë fillestare të Bankës, Banka nuk ndryshon klasifikimin e aktiveve të mbetura financiare të mbajtura në atë model biznesi, por përfshin informacion të tillë gjatë vlerësimit të aktiveve financiare të sapo ongjuruara ose ato të blera në vazhdim.

Testi SPPI

Si një hap i dytë i procesit të klasifikimit, Banka vlerëson kushtet kontraktuale të aktiveve financiare për të identifikuar nëse ata përmbushin testin SPPI. "Principali" për qëllim të këtij testi përcaktohet si vlera e drejtë e aktivitetit financiar në njohjen fillestare dhe mund të ndryshojë gjatë jetës së aktivitetit financiar (për shembull, nëse ka shlyesje të principalit ose amortizimin e primit / skontos). Elementët më të rëndësishëm të interesit në kuadër të marrëveshjes së huadhënies, janë zakonisht konsiderata për vlerën kohore të parasë dhe rrezikut të kreditit. Për të bërë vlerësimin SPPI, Banka zbaton gjykimin dhe shqyrton faktorët relevantë si monedha në të cilën është shprehur aktiviteti financiar dhe periudha për të cilën është përcaktuar norma e interesit.

Në të kundërt, kushtet kontraktuale që paraqesin një ekspozim më pak se minimumi ndaj rreziqeve ose paqendrueshmëri në fluksat monetare kontraktuale që nuk kanë lidhje me një marrëveshje bazë të huadhënies, nuk krijojnë fluksa kontraktuale të mjeteve monetare që janë vetëm pagesa e principalit dhe interesit mbi tepërcën e huasë. Në raste të tilla, aktiviteti financiar duhet të matet në VDFH

Instrumentet e borxhit në VDATGJ

Banka i vlerëson investimet e tjera financiare në VDATGJ nëse të dy kushtet e mëposhtme përmbushen:

- Instrumenti i mbajtur brënda një modeli biznesi, objektivi i të cilit arrihet duke mbledhur fluksat monetare kontraktuale dhe nga shitja e aktiveve financiare
- Kushtet kontraktuale të aktivitetit financiar përmbushin testin SPPI

Instrumentet e borxhit në VDATGJ janë matur më pas me vlerën e drejtë në fitimet dhe humbjet që vijnë si rezultat i ndryshimit të vlerës së drejtë të njohur në ATGJ. Të ardhurat nga interesi dhe fitimet dhe humbjet nga këmbimi i huaj njihen në fitim ose humbje në të njëjtën mënyrë si për aktivitetet financiare të matura me koston e amortizuar. Llogaritja HKP për instrumentet e borxhit shprehet në shënimin 4 J. Kur Banka mban më shumë se një investim në të njëjtën siguri, ato konsiderohen të disponueshme në bazën hyrje e parë dalje e parë. Nga çregjistrimi, fitimet ose humbjet kumulative të njohura më parë në ATGJ janë rklasifikuar nga ATGJ në fitim ose humbje.

Instrumentet e kapitalit në VDATGJ

Pas njohjes fillestare, Banka zgjedh herë pas here të klasifikojë në mënyrë të pakthyeshme disa nga investimet e saj të kapitalit si instrumente të kapitalit në VDATGJ, kur ato plotësojnë përkuqzimin e përcaktimit të kapitalit sipas SNK 32 *Instrumentet Financiare: Prezantimi* dhe nuk mbahen për tregtim. Një klasifikim i tillë përcaktohet mbi bazën instrument pas instrumenti.

Fitimet dhe humbjet nga këto instrumente të kapitalit nuk riciklohen kurrë në fitim. Dividentët njihen në fitim ose humbje si të ardhura të tjera operative kur është vendosur e drejta e pagesës, përveçse kur Banka përfiton nga të ardhurat e tilla si rikuperimi i një pjese të koston e instrumentit, në këtë rast, fitimet e tilla regjistrohen në ATGJ. Instrumentet e kapitalit në VDATGJ nuk i nënshtrohen një vlerësimi për zhvlerësimin.

BANKA AMERIKANE E INVESTIMEVE SHA

Shënime të pasqyrave financiare të veçanta më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

(Të gjitha shumat janë në mijë Lekë, përveçse kur shprehet ndryshe)

4. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE KRYESORE KONTABËL (VAZHDIM)

i) Aktive dhe detyrime financiare (vazhdim)

Banka nuk ka ndonjë instrument të tillë më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019.

Garancitë financiare, letrat e kreditit dhe angazhimet e huave të pashfrytëzuara

Banka leshon garanci financiare, letra krediti dhe angazhimet të huave.

Garancitë financiare njihen fillimisht në pasqyrat financiare të veçanta si zera jashtë bilancit dhe janë paraqitur ra angazhimet dhe eventualet me vlerën e drejtë, duke qenë prim i marrë. Pas njohjes fillestare, detyrimi i Bankës nën nivelin garanci matet më të lartën mes shumës së njohur fillimisht duke zbritur amortizimin kumulativ të njohur në pasqyrën e të ardhurave, dhe - një provizion HKP siç përcaktohet në Shënimin 4 J.

Primi i marrë njihet në pasqyrën e të ardhurave në të ardhurat neto nga komisionet me metodën tregtare përgjatë jetës së garancisë.

Angazhimet e huave të pashfrytëzuara janë angazhime për të cilat, gjatë kohëzgjatjes së angazhimit, Bankës i kërkohet t'i sigurojë klientit një kredi me kushte të paracaktuara. Kontratat e garancisë financiare janë në fushën e kërkesave të HKP-së.

Vlerat nominale kontraktuale të garancive financiare, letrave të kreditit dhe angazhimeve të huave të pashfrytëzuara, ku kredia për të cilën është rënë dakord është me kushtet e tregut, nuk regjistrohen në pasqyrën e pozicionit financiar.

Vlera; nom në të këtyre instrumenteve bashkë me HKP-të përkatëse janë paraqitur në Shënimin 12

jj) Riklasifikimi i aktiveve dhe detyrimeve financiare

Siç është prezantuar në shënimin 4.h), Banka nuk rklasifikon aktivet e saj financiare përtej njohjes së tyre fillestare, përveç situatave të jashtëzakonshme të përmendura në Standard. Gjatë vitit 2020, Banka identifikoi që një pjesë e instrumentave financiarë të përfuqara nga bashkimi me ish-NSG, mbajtën klasifikimin e tyre të mëparshëm si VDATGJ në vend që të klasifikoheshin në përputhje me politikën e Bankës. Në vitin korant, në përputhje me Politikën Kontabël IAS 8, Ndryshimet në Gabimet dhe Vlerësimet Kontabël, Banka rishikoi klasifikimin e këtij portofoli duke i klasifikuar si Investime financiare me kosto të amortizuar në përputhje me Modelin e Biznesit të Bankës për të gjitha investimet në letra me vlerë me normë të ndryshueshme.

Riklasifikimi nuk ndikoi në matjen e aktiveve duke qenë se vlera e drejtë në datën e bashkimit nuk ndryshon në krahasim me koston e amortizuar duke mos përur ndryshim në pasqyrën e fitimhumbjeve. Për më tepër detaje, shiko shënimin 14

k) Çregjistrimi i aktiveve dhe detyrimeve financiare

Çregjistrimi nga modifikimet thembësore të termave dhe kushteve

Banka çregjistrore një aktiv financiar të tillë si huaja për një klient, kur termat dhe kushtet janë rinegociuar në atë masë që, në thelb, bëhet një hua e re, me diferencën e njohur si fitim ose humbje nga çregjistrimi, deri në masën që një humbje nga zhvlerësimi nuk është regjistruar ende. Huatë e reja të njohura klasifikohen si Faza 1 për qëllimet e matjes së HKP-ve, përveçse kur kredia e re konsiderohet të jetë POCI. Gjatë vlerësimit nëse do të çregjistrohet një hua për një klient, ndër të tjera, Banka konsideron faktorët e mëposhtëm:

- Ndryshimi në monedhën e huasë
- Futja e një tipari të instrumentit të kapitalit
- Ndryshimi në kundërparti
- Nëse modifikimi është i tillë që instrumenti nuk do të përmbushë më kriterin e SPPI

Nëse modifikimi nuk rezulton në fluksa të mjeteve monetare që janë në thelb të ndryshme, modifikimi nuk rezulton në çregjistrim. Bazuar në ndryshimet në fluksat e mjeteve monetare të skontuara me NEI fillestar, Banka regjistron një fitim ose humbje modifikimi, në masën e përcaktuar të humbjes nga zhvlerësimi.

BANKA AMERIKANE E INVESTIMEVE SHA

Shënime të pasqyrave financiare të veçanta më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

(Të gjitha shumat janë në mijë Lekë, përveçse kur shprehet ndryshe)

4. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE KRYESORE KONTABËL (VAZHDIM)

k) Çregjistrimi i aktiveve dhe detyrimeve financiare (vazhdim)

Për detyrime financiare, Banka konsideron një modifikim si të konsiderueshëm bazuar në faktorët kualitativë dhe nëse rezulton në një diferencë ndërmjet vlerës aktuale të skontuar të rregulluar dhe vlerës kontabël të detyrimit financiar prej dhjetë përqind ose më shumë. Për aktivet financiare, vlerësimi bazohet në faktorë cilësorë.

Çregjistrime të tjera përveçse ato nga modifikimet thelbësore

Aktivet financiare

Një aktiv financiar (ose, kur është e mundur, një pjesë e një aktivi financiar ose pjesë e një grupi të aktiveve financiare të ngjashme) çregjistrohet kur të drejtat për të marrë fluksa monetare nga aktivi financiar kanë skaduar. Banka, gjithashtu çregjistron aktivin financiar nëse ka transferuar aktivin financiar si dhe transferimi kualifikohet për çregjistrim.

Banka ka transferuar aktivin financiar nëse dhe vetëm nëse:

- Banka ka transferuar të drejtat e saj kontraktuale për të marrë fluksa monetare nga aktivi financiar, ose
- Ajo ruan të drejtat për fluksat e mjeteve monetare, por ka marrë detyrimin për të paguar plotësisht fluksat monetare të marra pa vonesa materiale për një palë të tretë nën një marrëveshje 'kalimtare'.

Marrëveshjet kalimtare janë transaksione ku Banka ruan të drejtat kontraktuale për të marrë fluksat e mjeteve monetare të një aktivi financiar ("aktivi origjinal"), por merr një detyrim kontraktual për të paguar këto fluksa monetare në një ose më shumë njësive ekonomike ("përfutjesit eventuale"), kur të treja kushtet e mëposhtme janë plotësuar:

- Banka nuk ka asnjë detyrim të paguarë shumë për përfutjesit eventuale, përveç nëse ka arkëtuar shumën ekuivalente nga aktivi origjinal, duke përjashtuar parashikimet afatshkurtra me të drejten për marrjen e plotë të shumës së huasë plus interesin e përfundimtar me normat e tregut
- Banka nuk mund të shpase ose të vendosë si kolateral aktivin fillestar përveçse si siguri për marrësit eventuale
- Banka duhet të dorëzojë çdo fluks parash që mbledh në emër të përfutjesve eventuale pa vonesë materiale. Gjithashtu, Banka nuk ka të drejtë të ri-investojë fluksa të tilla të parash, me përjashtim të investimeve në mjete monetare ose ekuivalente të parash duke përfshirë interesin e fituar, gjatë periudhës midis datës së arkëtimit dhe datës së dergesës së kërkuar për përfutjesit eventuale.

Një transferim kualifikohet për çregjistrim vetëm nëse:

- Banka ka transferuar kryesisht të gjitha rrezikët dhe përfutjet e aktivit, ose
- Banka nuk ka transferuar asnjë thelbësi të gjitha rrezikët dhe përfutjet e aktivit, por ka transferuar kontrollin e aktivit.

Banka e konsideron kontrollin të transferuar nëse dhe vetëm nëse transferuesi ka aftësinë praktike për të shpërndarë në tërësi të tij për një palë të tretë të palidhur dhe është në gjendje ta ushtrojë atë aftësi në mënyrë të njëanshme dhe pa vendosur kufizime shtesë për transferimin.

Nëse Banka as nuk ka transferuar e as nuk mbajtur në mënyrë të konsiderueshme të gjitha rrezikët dhe përfutjet dhe ka mbajtur kontrollin e aktivit, aktivi vazhdon të njihet vetëm në masën e përfshirjes së vazhdueshme të Bankës, rast në të cilin, Banka njeh edhe një detyrim lidhur me të. Aktivet e transferuara dhe detyrimi i lidhur me të maten në një bazë që reflekton të drejtat dhe detyrimet që Banka ka mbajtur.

Përfshirja e vazhdueshme që merr formën e një garancie mbi aktivin e transferuar matet me vlerën me të ulët midis vlerës kontabël fillestare të aktivit dhe shumën maksimale të konsideratës që Bankës mund t'i kërkojë të paguajë.

BANKA AMERIKANE E INVESTIMEVE SHA

Shënime të pasqyrave financiare të veçanta më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

(Të gjitha shumat janë në mijë Lekë, përveçse kur shprehet ndryshe)

4. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE KRYESORE KONTABËL (VAZHDIM)

k) Çregjistrimi i aktiveve dhe detyrimeve financiare (vazhdim)

Nëse përfshirja e vazhdueshme merr formën e një opsioni të shkruar ose të blerë (ose të dyja) në aktivin e transferuar, përfshirja e vazhdueshme matet me vlerën që Bankës t'i kërkojë të paguajë gjatë blerjes. Në rastin e një kontrate me opsion të shkruar mbi një aktiv që matet me vlerë të drejtë, masa e përfshirjes së vazhdueshme të njësisë ekonomike është e limituar më të vogël e vlerës së drejtë dhe çmimit të ushtrimit të opsionit.

Detyrime financiare

Një detyrim financiar çregjistrohet kur detyrimi i lindur prej tij zbatohet, anulohet ose skadon. Kur një detyrim financiar ekzistues zëvendësohet me një tjetër nga i njëjti huadhues në kushte thelbësorë të ndryshme, ose kushtet e një detyrimi ekzistues ndryshohen në mënyrë thelbësore, zëvendësimi ose modifikimi i tillë trajtohet si një çregjistrim i detyrimit fillestar dhe njihet si një detyrim i ri. Diferenca midis vlerës kontabël të detyrimit financiar fillestar dhe vlerës së paguar njihet në fitim ose humbje.

l) Zhvlerësimi i aktiveve financiare

Vështrim i përgjithshëm i parimeve të HKP

Banka ka regjistruar një fond zhvlerësimi për humbjet e pritshme të kredisë për të gjitha huatë dhe aktivet e tjera financiare të bankës që nuk mbahen në VDFH, së bashku me angazhimet e huasë dhe kontratat e garancisë financiare, në këtë pjesë të gjitha të quajtura si 'instrumente financiare'. Instrumentet e kapitalit nuk janë subjekt i zhvlerësimit sipas SNRF 9.

Fondi i zhvlerësimit HKP bazohet në humbjet e kredisë që pritet të lindin gjatë jetës së aktivit (humbja e pritshme e kredisë për jetë ose AGJHKP), përveç nëse nuk ka pasur një të konsiderueshme të rrezikut të kredisë që nga krijimi, rast në të cilin, fondi bazohet në humbjen e pritshme të kredisë në 12 muaj (12mHKP).

Polibkal o Bankës për të përcaktuar nëse ka pasur një rritje të konsiderueshme në rrezikun e kredisë janë paraqitur në Shënime 9.

HKP 12-mujore është pjesë e AGJHKP që përfaqëson HKP që rezulton nga ato ngjarje të dështimi në instrumentet financiare që janë të mundshëm brenda 12 muajve pas datës së raportimit.

Të dy AGJHKP dhe 12mHKP janë llogantur në bazë individuale ose në bazë kolektive, në varësi të natyrës së portofolit të instrumenteve financiare.

Banka ka krijuar një politikë për të kryer një vlerësim, në fund të çdo periudhe raportuese, nëse rreziku

i kredisë i në instrumenti financiar është rritur ndjeshëm që nga njohja fillestare, duke marrë parasysh ndryshimin në rrezikun e dështimit që ndodh gjatë jetës së mbetur të instrumentit financiar.

Bazuar në procesin e mësipërm, Banka grumbullon kredinë e saj në Fazën 1, Fazën 2, Fazën 3 dhe POCI, sipërshtrohet më poshtë:

- Faza 1: Kur kreditë njihen për herë të parë, Banka njeh një zhvlerësim në bazë të 12mHKP. Kredite e Fazës 1 gjithashtu përfshijnë kredi ku rreziku i kredisë është përmirësuar dhe kredia është rklasifikuar nga Faza 2.
- Faza 2: Kur një kredi ka shfaqur një rritje të konsiderueshme në rrezikun e kredisë që nga krijimi, Banka regjistron një fond për AGJHKP-te. Kredite e Fazës 2 gjithashtu përfshijnë kredi, ku rreziku i kredisë është përmirësuar dhe kredia është rklasifikuar nga Faza 3.
- Faza 3: Kredite që konsiderohen të zhvlerësuar plotësisht. Banka regjistron një fond për AGJHKP.
- POCI: Aktivet e blera ose të origjinuara të zhvlerësuar ("POCI") janë aktivet financiare që janë të zhvlerësuar që në njohjen fillestare. Aktivet POCI regjistrohen me vlerën e drejtë në njohjen fillestare dhe të ardhurat nga interesi njihen më pas në bazë të një NEI të rregulluar. HKP-të njihen ose marrin vetëm në masën që ka një ndryshim pasles në humbjet e pritshme të kredisë. Aktivet e zhvlerësuar të kredisë të fituara në një kombinim biznesi nuk trajtohen si POCI.

BANKA AMERIKANE E INVESTIMEVE SHA

Shënime të pasqyrave financiare të veçanta më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

(Të gjitha shumat janë në mijë Lekë, përveçse kur shprehet ndryshe)

4. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE KRYESORE KONTABËL (VAZHDIM)

l) Zhvlerësimi i aktiveve financiare (vazhdim)

Për aktivet financiare për të cilat Banka nuk ka pritshmëri të arsyeshme për rikuperimin e të gjithë shumës së mbetur, ose një pjesë të saj, vlera kontabël bruto e aktivit financiar zvogëlohet. Ky konsiderohet një çregjistrim (i përshtetshëm) i aktivit financiar.

Përllogaritja e HKP-ve

Banka llogarit HKP-te në baza të tre skenarëve të ponderuar me probabilitet e ndodhjes për të matur mundësitë e suksesit të pritshme të arkëtimit, të skontuara në një përaftrim me NEI. Një mundësi e arkëtimit të pritshme është diferenca midis fluksave të jetëve monetare kontraktuale të pritshme dhe atyre që njësisë ekonomike pret të arkëtojë.

Mënyra e llogaritjes HKP është përshkruar më poshtë dhe elementet kryesorë janë si vijon:

- **PD – Mundësia e dështimit ("PD")** është një vlerësim i mundësisë së dështimit gjatë një horizonti kohor të dhënë. Një dështim mund të ndodhë vetëm në një kohë të caktuar gjatë periudhës së vlerësimit, nëse aktivi nuk është çregjistruar më parë dhe vazhdon të qëndrojë në portofolin e Bankës.
- **EAD – Ekspozimi në Dështim ("EAD")** është një vlerësim për ekspozimin në një datë të ardhshme dështimi, duke marrë në konsideratë ndryshimet e pritshme në ekspozim pas datës së raportimit duke përfshirë parapagimet e principalit dhe interesit, të skeduluar në kontratë apo jo, tërheqjet e pritshme në angazhime për financim të drejta, dhe interesat nga pagesat e pakryera.
- **LGD – Dështimi në humbje ("LGD")** është një vlerësim i humbjes që del në rastin kur ndodh një dështim në një kohë të dhënë. Ai bazohet në diferencën midis fluksave kontraktuale të arkëtimit dhe atyre që huadhënësi pret të arkëtojë.

Për llogaritjen e HKP-ve, Banka konsideron tre skenare (baze, optimist dhe pesimist).

Secila prej tyre shoqërohet me PD të ndryshme. Kur është e rëndësishme, vlerësimi i skenarëve të shumtë përfshin gjithashtu se si pritet të rikuperohen huatë e paguara, duke përfshirë dhe mundësinë që huatë do të kurohen dhe vlera e kolateralit ose shumë mund të merret nga shitja e aktivit.

Periudha maksimale për të cilën përcaktohen humbjet e kreditit është jeta kontraktuale e një instrumenti financiar, përveç nëse Banka ka të drejtën ligjore të quajë atë më heret. Humbjet dhe lëshimet nga zhvlerësimi llogaritet dhe shpallëhen voçmas nga humbjet ose fitimet e modifikimit që llogaritet si një rregullim i vlerës kontabël bruto të aktivit financiar.

Mekanika e metodës HKP është përmbledhur më poshtë:

- **Faza 1:** 12m HKP llogaritet si pjesë e AGJHKP-ve që përfaqësojnë HKP-të që rezultojnë nga ngjarjet e dështimit të një instrumenti financiar që janë të mundshme brenda 12 muajve pas datës së raportimit. Banka llogarit fondin e 12m HKP bazuar në pritshmërinë e një mospagimi që ndodh në 12 muajt pas datës së raportimit. Këto probabilitete të dështimit të pritur 12-mujor aplikohen mbi një EAD të parashikuar dhe shumëzohen me LGD-në e pritshme dhe të skontuar me një NEI të përafërsuar me origjinalin. Kjo llogaritje bëhet për secilin nga tre skenarët, siç është shpjeguar më sipër.
- **Faza 2:** Kur një hua ka shfaqur një rritje të konsiderueshme të rrezikut të kreditit që nga krijimi i saj, Banka regjistron një fond për AGJHKP. Mekanika është e ngjashme me ato të shpjeguara më sipër, duke përfshirë përdorimin e skenarëve të shumtë, por PD-të vlerësohen gjatë gjithë jetës së instrumentit. Mundësitë e arkëtimit të pritura të parave skontohen me një përafërsim të NEI-t origjinal.
- **Faza 3:** Për kreditet që konsiderohen si të zhvlerësues, Banka njeh humbjet e pritshme gjatë gjithë jetës për këto kredi me llogaritje zhvlerësimi individual. Si parim, shumë e provizionit e kredive që zhvlerësohen në baza individuale llogaritet si diferenca ndërmjet shumës së mbetur paguar të kreditit me a) shumën e kolateralit likuid dhe me b) shumën e vlerës aktuale të të gjitha fluksave monetare të ndryshme të zbritura me normën aktuale të interesit të kreditit;

BANKA AMERIKANE E INVESTIMEVE SHA

Shënime të pasqyrave financiare të veçanta më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

(Të gjitha shumat janë në mijë Lekë, përveçse kur shprehet ndryshe)

4. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE KRYESORE KONTABËL (VAZHDIM)

l) Zhvlerësimi i aktiveve financiare (vazhdim)

- Aktivet POCI janë aktive financiare që janë të zhvlerësues që në njohjen fillestare. Banka njeh vetëm ndryshimet kumulative AGJHKP që nga njëjta fillestare, bazuar në tre skenarë me probabilitete, skontuar nga NEI i rregulluar.

Angazhimet e huave, letrat e kreditit dhe garancitë financiare:

Faktori i konvertimit të kreditit përdoret për të kthyer shumën e një linje krediti (pjesa e papërdorur) dhe shumë të tjera jashtë bilancit në një shumë të EAD. Është një supozim i modeluar, i cili përfaqëson një pjesë të çdo ekspozimi të papërdorur që pritet të tërhiqet para se të ndodhë një ngjarje e paracaktuar. Për secilin lloj produkti, faktori CCF për Bankën zbatohet si më poshtë:

- Letër garancia & letrë krediti me maturitet të mbetur ≤ 1 vit = 20%
- Letër garancia & letrë krediti me maturitet të mbetur > 1 vit = 50%
- Pjesa e papërdorur e kredive me afat = 0%
- Pjesa e papërdorur e overdrashtëve = 20%
- Pjesa e papërdorur e kartave të kreditit = 20%

Instrumente të borxhit të matura me vlerën e drejtë nepërmjet ATGJ

HKP-ja për instrumente të borxhit të matura në VDATGJ nuk e zvogëlojnë vlerën kontabël të këtyre aktiveve financiare në pasqyrën e pozicionit financiar, e cila mbetet me vlerën e drejtë. Përkundrazi, një shumë e rrejtë me fondin, që do të kërkojë nëse aktivet që maten me koston e amortizuar, njihet në ATGJ si një shumë zhvlerësimi e akumuluar, me një ngarkimin përkatës në fitim ose humbje. Humbja e akumuluar e njohur në ATGJ do të rikohet në fitim ose humbje në momentin e çregjistrimit të aktivit.

Aktive financiare të blera ose të gjeneruara të zhvlerësues (POCI)

Për aktivet financiare POCI, Banka njeh vetëm ndryshimet kumulative në AGJHKP që nga njohja fillestare në fondin e humbjeve.

Informacion për ndodhjet që priten të ndodhin

Në modelet e saj HKP, Banka mbështetet në një gamë të gjërë informatesh të ardhshme, si inpute ekonomike, si:

- Rritja e Produktit të Brendshëm Bruto ("PBB")
- Normat e papunësisë
- Normat baza të Bankës Qendrore
- Normat e inflacionit

Inputet dhe modelet e përdorura për llogaritjen e HKP-ve nuk mund të kapin gjithnjë karakteristikat e tregut në datën e pasqyrave financiare. Për të pasqyruar këtë, rregullime cilësore bëhen herë pas here si rregullime të perkohshme kur dallimet e tilla janë dukshëm materiale.

m) Përmirësimet e kreditit: vlerësimi i kolateralëve dhe garancitë financiare

Për të zvogëluar rrezikun e kreditit mbi aktivet financiare, Banka kërkon të përdorë kolaterale, kur është e mundur. Kolaterali vjen në forma të ndryshme, të tilla si para, letra me vlerë, letra krediti / garanci, pasuri të paluajtshme, arkëtime, inventarë dhe aktive të tjera jo-financiare. Kolaterali, përveç nëse merret në pronësi, nuk regjistrohet në pasqyrën e pozicionit financiar të Bankës.

Sidoqoftë, vlera e drejtë e kolateralit ndikon në llogaritjen e HKP-ve. Në përgjithësi vlerësohet në minimum, në fillim dhe rivlerësohet në baza të shpeshta (periudha të ndryshme për lloje të ndryshme). Për shembull për kolateralin pasuri të paluajtshme, frekuenca është vjetore (ambjenta biznesi) ose çdo 3 vjet (ambjenta ban mi). Sidoqoftë, disa kolaterale, për shembull, para ose letra me vlerë që kanë të bëjnë me kërkesat e margjinalizimit, vlerësohen çdo ditë.

Më afër sa është e mundur, Banka përdor të dhëna të tregut aktiv për vlerësimin e aktiveve financiare të mbajtura si kolateral. Aktivet e tjera financiare që nuk kanë vlera të tregut të përcaktueshme

BANKA AMERIKANE E INVESTIMEVE SHA

Shënime të pasqyrave financiare të veçanta më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

(Të gjitha shumat janë në mijë Lekë, përveçse kur shprehet ndryshe)

4. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE KRYESORE KONTABEL (VAZHDIM)

m) Përmirësimet e kredisë: vlerësimi i kolateralëve dhe garancitë financiare (vazhdim)

Lehtësisht, vlerësohen duke përdorur modele. Kolaterali jo-financiar, siç është pasuria e paluajtshme, vlerësohet bazuar në të dhënat e paraqitura nga palët e treta siç janë vlerësuesit e brendshëm / të jashtëm të pasurive.

Nëse një kredi, si pjesë e kushteve të saj kontraktuale, është e garantuar nga një palë e treta, Banka vlerëson HKP përkatëse bazuar në rrezikun e kombinuar të kredisë së garantuesit dhe palës së garantuar, duke reflektuar garancinë në matjen e humbjes në rast dështimi (LGD). Banka e konsideron garancinë financiare si përbërëse të kushteve kontraktuale të kredisë së garantuar, kur garancia është bare në të njëjten kohë, ose brenda një kohe të shkurtër, pas avancimit të kredisë.

Garancitë që nuk janë përsëritëse për kushtet e kontratës së kredisë, llogariten si njësi e veçante e loganve që i që janë subjekti i HKP-së.

n) Inventari (aktive të marra në zotërim)

Politika e Bankës përcakton nëse një aktiv i marrë në zotërim mund të përdoret për operacionet e brendshme ose duhet shitur. Aktivet e përcaktuara si të dobishme për operacionet e brendshme transferohen në kategorinë përkatëse të aktiveve me vlerën më të ulët midis vlerës së marrjes në pronësi ose vlerës kontabel të aktivit origjinal. Aktivet për të cilat shita përcaktohet të jetë një opsion më i mirë transferohen në aktivet e mbajtura për shitje me vlerën e tyre të drejtë (nëse janë aktive financiare) dhe vlerën e drejtë pakësuar me koston për të shitur për aktivet jo-financiare në datën e rimarrjes, në përputhje me poshtkën e Bankës.

Në rrjedhën e saj normale të biznesit, Banka angazhon agjentë të jashtëm për të rikuperuar fonde nga aktivet e rivlerësuar, përgjithësisht në ankapë, për të shlyer borxhin e mbetur. Çdo fond i tepërt u kthehet klientëve / debitorëve. Si rezultat i kësaj praktike pronal e banamit në proceset e riblerjes ligjore nuk janë regjistruar në bilanc.

o) Fshirjet

Aktivt financiarë fshihen pjesërisht ose tërësisht vetëm kur Banka nuk ka prishmëri të arsyeshme për të rikuperuar një aktiv financiar në tërësi ose një pjesë të tij. Nëse shumat që duhet të fshihen është më e madhe se fondet e zhvlerësimit të akumuluar, diferenca fillimisht trajtohet si shtesë e këtij fondi, i cili më pas aplikohet ndaj vlerës kontabel bruto. Çdo rimarrje pasuese kreditonit të shpenzimit i humbjeve të kredisë.

p) Hua të ristrukturuara dhe modifikuara

Banka ndonjëherë bën lëshime ose modifikime të kushteve origjinale të kredisë si përgjigje ndaj vështirësive financiare të huamarrësit, në vend që të marrë në pronësi ose të zbatojë ndryshe mbledhjen e kolateralit.

Banka e konsideron një kredi të ristrukturuar kur lëshime të tilla ose modifikime janë dhënë si rezultat i vështirësive financiare aktuale ose të pritura të huamarrësit dhe Banka nuk do të kishte pranuar nëse huamarrësi do të ishte i shëndetshëm financiarisht. Treguesit e vështirësive financiare përfshijnë dështim në kovenantë ose shqetësimet e rëndësishme të agjitura nga Njësia e Menaxhimit të Riskut të Kredisë.

Ristrukturimi mund të përfshijë zgjerimin e marrëveshjeve të pagosës dhe marrëveshjen me kushtet e reja të kredisë. Pasi termat janë rinegociuar, çdo zhvlerësim matet duke përdorur NEI-n origjinal siç është llogaritur para modifikimit të termave. Është politikë e Bankës monitorimi i kredive të ristrukturuara për të siguruar që pagesat në të ardhmen të vazhdojnë të ndodhin.

Vendimet e çregjistrimit dhe klasifikimi midis Fazës 2 dhe Fazës 3 përcaktohen në bazë të kriterëve të paracaktuar. Nëse këto procedura identifikojnë një humbje në lidhje me një kredi, ajo shpallet dhe menaxhohet si një aktiv i zhvlerësuar i Fazës 3 derisa të arketohet penudha e provës të përfunduar me sukses, ose të shlyhet.

Kur kredia është ristrukturuar ose modifikuar por nuk është çregjistruar, Banka rivlerëson gjithashtu nëse ka pasur rreze të ndjeshme në rrezikun e kredisë. Banka konsideron nëse aktivet duhet të klasifikohen si Faza 3.

BANKA AMERIKANE E INVESTIMEVE SHA

Shënime të pasqyrave financiare të veçanta më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

(Të gjitha shumat janë në mijë Lekë, përveçse kur shprehet ndryshe)

4. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE KRYESORE KONTABEL (VAZHDIM)

p) Hua të ristrukturuara dhe modifikuara (vazhdim)

Sapo një aktiv të jetë klasifikuar si i ristrukturuar, ai do të mbetet i ristrukturuar për një periudhë minimale provë 12-mujore. Në mënyrë që huaja të rriklassifikohet nga kategoria e ristrukturimeve, klienti duhet të plotësojë të gjitha kriteret e mëposhtme:

- Të gjitha ekspozimet e tij konsiderohen si performuese
- Penudha e provës prej një viti ka kaluar që nga data që kontrata e ristrukturimit konsiderohej si performuese
- Klienti nuk ka më kontrata që kanë më shumë se 30 ditë vonësa

q) Vlera e drejtë e instrumenteve financiare

Vlera e drejtë është çmimi më të cilin aktiv mund të shitet, ose një detyrim të transferohet, në një transaksion të zakonshëm në tregun kryesor (ose më të favorshëm) në datën e matjes, nën kushtet aktuale të tregut (p.sh. një çmim dalje) pavarësisht nëse ai çmim është direktë i vëzhgueshëm ose i vlerësueshëm duke përdorur metodë tjetër vlerësimi. Kur vlerat e drejta të aktiveve dhe detyrimeve financiare të regjistruara në pasqyrën e pozicionit financiar nuk mund të llogariten nga tregjet aktive, ato përcaktohen duke përdorur një shumëllojshmëri teknikash vlerësimi që përfshijnë dhe përdorimin e modeleve të vlerësimit. Inputet në këto modele marrin nga tregjet të vëzhgueshme ku është e mundur, por kur këto nuk është e mundur, vlerësimi kërkohet në përcaktimin e vlerave të drejtë. Gjykimet dhe vlerësimet përfshijnë konsideratë për likuiditetin dhe inpute të modeleve të bçhura në zëra si rreziku i kredisë (si i veti ashtu dhe i palëve), rregullimet e vlerës së financimit, korrelacionin dhe paqëndrueshmërinë. Për më shumë detaje rreth përcaktimit të vlerës së drejtë, ju lutemi shikoni Shënimin 10.

r) Mjete monetare dhe të ngjashme

Mjete monetare dhe të ngjashme përfshijnë para në arkë, balanca në Bankën Qendrore të pakufizuara në përdorim dhe aktive financiare shuma likvide me maturim fillestar deri në tre muaj ose më pak nga data e blerjes, të cilat kanë rrezik të pakonsiderueshëm ndryshimi të vlerës së tyre të drejtë, dhe përdoren nga Banka për menaxhimin e angazhimeve afatshkurtra.

s) Marrëveshjet e blerjes dhe të riblerjes

Letrat me vlerë të shitura nën një marrëveshje për t'u riblerë në një datë specifike në të ardhmen nuk çregjistrohen nga pasqyra e pozicionit financiar ndërsa Banka mban në mënyrë thelbësore të gjitha rrezikot dhe përfshimet e pronësisë.

Paratë përkatëse të marra njihen në pasqyrën e pozicionit financiar si një aktiv me detyrim në përkatëse për këmbimin e tyre, përfshirë interesin e përlogaritur si një detyrim brenda kolateralit të parave mbi letrat me vlerë të trena dhe marrëveshjet e riblerjes, duke pasqyruar substancën ekonomike të transaksionit si një kredi ndaj Bankës.

Diferenca midis çmimeve të shites dhe blerjes trajtohet si shpenzim i interesit dhe përlogaritë gjatë gjithë jetës së marrëveshjes duke përdorur NEI. Kur kundërpala ka të drejtë të shesë ose të rivendosë letrat me vlerë, Banka i rriklassifikon ato letra me vlerë në pasqyrën e pozicionit financiar si letra me vlerë të mbajtura për tregtim të vena si kolateral ose si investime financiare VDATGJ të vena si kolateral, siç është e përshtatshme.

Në të kundërt, letrat me vlerë të blera të lidhura me marrëveshjen për t'u shitur në një datë të caktuar të ardhshme nuk njihen në pasqyrën e pozicionit financiar. Shumë e paguar, përfshirë interesin e përlogaritur regjistrohet në pasqyrën e pozicionit financiar, brenda kolateralit; të parave të gatshme për letrat me vlerë të huazvara dhe marrëveshjet e riblerjes të anashjellta duke pasqyruar substancën ekonomike të transaksionit si një kredi nga Banka. Diferenca midis çmimeve të blerjes dhe rishijes regjistrohet në të ardhurat neto nga interesi dhe është përlogaritur gjatë gjithë jetës së marrëveshjes duke përdorur NEI.

Nëse letrat me vlerë, të blera në bazë të një marrëveshjeje për t'u rishitur, i shiten më pas një palë të treta, detyrimi për këmbimin e letrave me vlerë regjistrohet si një shije e shkurtër brenda detyrimeve financiare të mbajtura për tregtim dhe matet me vlerën e drejtë me çdo fitim ose humbje të përfshirë në të ardhurat neto nga tregtimi.

BANKA AMERIKANE E INVESTIMEVE SHA

Shënime të pasqyrave financiare të veçanta më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

(Të gjitha shumat janë në mijë Lekë, përveçse kur shprehet ndryshe)

4. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE KRYESORE KONTABËL (VAZHDIM)

t) SNRF 16 Qiratë (vazhdim)

(i) Shoqëria si qiramarrës

përdorur një normë skontimi të pandryshuar. Përfshijmë rastet kur ndryshimi në pagesat e qirasë rezulton nga ndryshimi i normave të interesit të ndryshueshme, rast në të cilin norma e skontimit ndryshohet për të pasqyruar dhe ndryshimin në nominat e interesit.

Për t'u përgjigjur nevojave të biznesit veçanërisht në kërkesën për hapësirë për zyra, Shoqëria do të hyjë në të negociata me pronarët për të rritur ose ulur hapësirën e disponueshme për zyra ose për të rinegociuar shumat e pagueshme sipas qirave përkatëse. Në disa raste, Shoqëria është në gjendje të mësojë kapacitetin e zyrës, duke marrë në dispozicion hapësira shtesë të lira dhe duke rënë dakord me qiradhënësin për të paguar në shumë që është në përpyesetim me çmimet e secilas për të pasqyruar kushtet përkatëse të kontratës. Në këto situata, marrëveshja kontraktuale trajtohet si një qira e re dhe llogariten në përputhje me rrethanat.

Në raste të tjera, Shoqëria është në gjendje të negociojë një ndryshim të një kontrate qiraje, si uljen e shumës së hapësirës për zyra, zvogëlimin e afatit e qirasë ose zvogëlimin e shumës totale të pagueshme për qiranë. Këto komponentë nuk ishin pjesë e kushteve origjinale të qirasë. Në këto situata, Shoqëria nuk i konsideron këto komponentë si ndryshime, por i trajton si një kontratë e re qiraje.

Në vend të kësaj, pagesat e rishkruara kontraktuale skontojnë duke përdorur një normë të rishikuar të skontimit në datën kur qiraja modifikohet në mënyrë afektive. Për arsytet e shpjeguara më sipër, norma e skontimit është norma e bazuar të Shoqërisë e përcaktuar në datën e modifikimit, pasi norma e rishikuar në qira nuk është e lehtë për t'u përcaktuar. Rishikimi i detyrimit të qirasë sjell një zvogëlim të vlerës kontabël të aktivit me të drejtë përdorim, për të pasqyruar performancën e plotë ose të pjesshëm të qirasë për ato modifikime të sa, që zvogëlojnë fushëveprimin e qirasë. Çdo fitim ose humbje në lidhje me përfitimin në një pjesë ose të plotë të qirasë njihet në fitim ose humbje. E drejta e përdorimit të aktivit riveletohet për të pasqyruar të gjitha modifikimet e tjera të qirasë.

Shoqëria ka zgjedhur të aplikojë përjashtimin për qiratë afatshkurtra dhe qiratë e aktiveve me vlerë të ulët duke përdorur qëllimet praktike. Këto qira kanë të bëjnë me sendet e pajisjeve të zyrës si tavolina, karrige dhe

pajisje të caktuara IT. Në vend që të njihin një aktiv me të drejtë përdorim dhe një detyrim qiraje, pagesat

në lidhje me këto qira njihen si një shpenzim periodik në pasqyrën e fitimit ose humbjes.

(ii) Shoqëria si qiradhënëse

Si qiradhënëse Shoqëria klasifikon qiratë e tij si qira operative ose financiare. Një qira klasifikohet si një qira financiare nëse i transferon të gjitha rreziqet dhe përfitimet tek qiramarrësi.

u) Aktive afatgjata materiale

(i) Njohja dhe matja

Aktivet afatgjata materiale maten me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe humbjet nga zhvlerësimi. Kostot përfshijnë të gjitha shpenzimet të cilat lidhen drejtpërdrejtë me blerjen e aktivit. Nëse pjesë të një aktivi afatgjatë material kanë jetë të dobishme të ndryshme, atëherë këto pjesë kontabilizohen si zëra të veçanta (përbërës kryesor) të aktiveve afatgjatë materiale. Çdo fitim ose humbje nga shitja ose nxjerrja jashtë përdorimit i një aktivi afatgjatë (të llogaritur si diferenca midis të ardhurave neto nga shitja e aktivit dhe vlerës kontabël të aktivit) njihet të të ardhurat e tjera në fitim ose humbje.

(ii) Kosto të tjera pasuale

Kostot e zëvendësimit të një pjesë të aktivit njihen me vlerën kontabël të aktivit nëse është e mundur që përfitime të ardhshme ekonomike që lidhen me këtë aktiv do të rrjedhin për Bankën dhe nëse kostot e të mund të maten në mënyrë të besueshme.

BANKA AMERIKANE E INVESTIMEVE SHA

Shënime të pasqyrave financiare të veçanta më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

(Të gjitha shumat janë në mijë Lekë, përveçse kur shprehet ndryshe)

4. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE KRYESORE KONTABËL (VAZHDIM)

u) Aktive afatgjata materiale (vazhdim)

(iii) Amortizimi

Amortizimi njihet në fitim ose humbje duke përdorur metodën lineare përgjatë jetës së dobishme të vlerësuar të çdo pjesë të aktivit afatgjatë material. Trualli dhe veprat e artit nuk zhvlerësohen

Jeta e dobishme e vlerësuar për periudhën aktuale janë të paraqitura si më poshtë.

	Në vite
• Ndërtesa	40
• Mobilje dhe pajisja zyre	5
• Automjete	5
• Përmirësimet e ambienteve të marra me qira	9-12
• Kompjuterat dhe pajisjet elektronike	4-5

Aktivet nuk amortizohen dari në momentin që fillojnë të përdoren dhe transferohen nga aktive në ndërtim apo zhvillim, në kategorinë përkatëse të aktiveve.

E drejta e përdorimit të aktiveve paraqiten së bashku me pronat dhe pajisjet në pasqyrën e pozicionit financiar. E drejta e përdorimit të aktiveve zhvlerësohen metodën lineare gjatë afatit të qirasë dhe jetës së dobishme të vlerësuar të aktiveve.

v) Aktiva afatgjata jomateriale

Aktivet afatgjata jomateriale paraqiten me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe çdo humbje nga zhvlerësimi. Amortizimi llogaritet duke përdorur metodën lineare përgjatë jetës së dobishme të vlerësuar të aktivit. Jeta e dobishme e vlerësuar paraqitet si më poshtë:

	Në vite
• Programe dhe aplikacione të teknologjisë informative	4-10

w) Zhvlerësimi i aktiveve jofinanciare

Vlera kontabël e aktiveve jofinanciare të Bankës, të ndryshme nga aktivet tatimore të shtrita dhe inventarët, rishikohen çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse ka ndonjë tregues për zhvlerësim. Nëse ka një tregues të tillë, atëherë vlerësohet vlera e rikuperueshme e aktivit. Humbja nga zhvlerësimi njihet në rast se vlera kontabël e aktivit është më e madhe se vlera e tij e rikuperueshme. Një njësi gjeneruese e mjeteve monetare është grup më i vogël i identifikueshëm i aktiveve i cili gjeneron fluksa monetare, të cilat në masë të madhe janë të pavarura nga aktivet e tjera ose grupet e tjera të aktiveve. Humbjet nga zhvlerësimi njihen në fitim ose humbje. Humbjet nga zhvlerësimi të lidhura me njësitë që gjenerojnë fluksa monetare janë njohur fillimisht për të pakësuar vlerën kontabël të emrit të marrë të alokuar kësaj njësi gjeneruese të mjeteve monetare dhe më pas për të ulur vlerën kontabël të aktiveve të tjera të njësisë gjeneruese të mjeteve monetare (grup njësisish gjeneruese të mjeteve monetare), me bazë të ponderuar.

Vlera e rikuperueshme e një aktivi ose e njësisë gjeneruese së mjeteve monetare është më e madhe midis vlerës në përdorim dhe vlerës së drejtë duke zbritur koston e shijes. Në vlerësimin e vlerës në përdorim, fluksat e vlerësuarra monetare të ardhshme janë skontuar në vlerën e tyre aktuale duke përdorur një normë skontimi para tatimit që reflekton vlerësimat aktuale të tregut për vlerën në kohë të parase dhe rreziqet specifike për aktivin.

x) Provizionet

Një provizion njihet nëse, si rezultat i një ngjarje në të kaluarën, Banka ka një detyrim ligjor ose konstruktiv dhe ka të ngjarë të ketë një dalje të burimeve ekonomike për shlyerjen e detyrimit. Provizionet përcaktohen duke skontuar fluksat e pritshme monetare me një normë para tatimit, e cila reflekton vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parase dhe sty ku është e përshkueshme, edhe rreziqet specifike ndaj detyrimit. Shpenzimet lidhur me çdo provizion prezantohen në pasqyrën e të ardhurave neto nga çdo rimbursim në shpenzime të tjera operationale.

BANKA AMERIKANE E INVESTIMEVE SHA

Shënime të pasqyrave financiare të veçanta më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

(Të gjitha shumat janë në mijë Lekë, përveçse kur shprehet ndryshe)

4. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE KRYESORE KONTABEL (VAZHDIM)

y) Përfitimet e punonjësve

Banka paguan vetëm kontributet e detyrueshme për sigurimet shoqërore, të cilat përfitohen nga punonjësit pas daljes në pension. Autoritetet lokale janë përgjegjëse për përcaktimin e limitit minimal ligjor të vendosur për pensionet në Shqipëri sipas një plani kontributesh të përcaktuar. Kontributet e Bankës për planin e pensionit ngarkohen në fitim ose humbje në momentin kur ato ndodhin.

5. MANAXHIMI I RREZIKUT

Përdorimi i instrumenteve financiare e ekspozon Bankën ndaj rreziqeve të mëposhtme:

- rreziku i kredisë
- rreziku i likuiditetit
- rreziku i tregut
- menaxhimi i kapitale

Ky shënim paraqet informacion mbi ekspozim të Bankës ndaj çdo rreziku të përmendur me lart objektivat e Bankës, politikat dhe proceset e Bankës për vlerësimin dhe menaxhimin e rrezikut, dhe menaxhimin e kapitale të Bankës.

Kuadri i administrimit të rrezikut

Bordi i Drejtuesve ka përgjegjësi për vendosjen dhe mbikqyrjen e kuadrit të menaxhimit të rrezikut të Bankës. Bordi ka krijuar Komitetin e Aktiveve dhe Detyrimeve (ALCO) dhe Komitetin e Rrezikut të Kredisë dhe Çështjeve Sensitive (SAC), dhe komitetin e Provizionimit, të cilët kanë përgjegjësi për zhvillimin dhe monitorimin e politikave të menaxhimit të rrezikut të Bankës në fushat e tyre specifike. Të gjithë komitetet e Bordit kanë anëtarë ekzekutivë dhe jo-ekzekutivë dhe raportojnë rregullisht tek Bordi i Drejtuesve për aktivitetet e tyre.

Politikat e menaxhimit të rrezikut janë hartuar që të evidentojnë dhe të analizojnë rreziqet e hasura nga Banka, për të vendosur kufizime dhe kontrolle dhe për të monitoruar zbatimin e këtyre kontrolleve. Politikat e menaxhimit të rrezikut rishikohen rregullisht për të reflektuar ndryshimet në kushtet, produktet dhe shërbimet e tregut.

Banka nëpërmjet trajnimeve dhe standardave dhe procedurave drejtuese, synon të zhvillojë një mjedis kontrolli të disiplinuar dhe konstruktiv në të cilin çdo punonjës të kuptojë rolin dhe detyrimet e katëse.

Komiteti i Auditit i Bankës është përgjegjës për monitorimin e përputhshmërisë me politikat dhe procedurat e menaxhimit të rrezikut dhe për të vlerësuar njohuritë dhe strukturën e administrimit të rrezikut në lidhje me rreziqet e hasura nga Banka. Për të kryer funksionet e vetë Komiteti i Auditit mbështetet nga Auditit i Brendshëm. Auditit i brendshëm vëzhgon në mënyrë të rregullt dhe ad-hoc politikat dhe procedurat e administrimit të rrezikut dhe raporton rezultatet e vëzhgimeve tek Komiteti i Auditit.

(a) Rreziku i kredisë

Gjatë aktivitetit normal të saj, Banka ekspozohet ndaj rrezikut të kredisë nga huatë dhe parashënimet ndaj klientëve dhe institucioneve financiare, nga investimet në letra me vlerë dhe në zëra të tjerë jashtë bilanci. Rreziku i kredisë është rreziku i humbjes financiare të Bankës në rast se huamarrësit ose pala tjetër e një instrumenti financiar nuk përmbush detyrimet kontraktuale, dhe ky rrezik buron kryesisht nga huatë dhe parashënimet e klientëve dhe nga letrat me vlerë të bonusit dhe financimet ndaj institucioneve financiare ose zëra të tjerë jashtë bilanci. Për qëllime të raportimit të menaxhimit të rrezikut, Banka konsideron dhe konsolidon të gjithë elementët e ekspozimit të rrezikut të kredisë (si rreziku i mospërmbushjes së detyrimit individual, rreziku sovran ose i industrisë). Banka menaxhon rrezikun e ekspozimit të kredisë sistematikisht duke monitoruar drejtpërdrejtë limitet e kredive, portofolin e kredive dhe përqëndrimin e ekspozimit.

Menaxhimi i rrezikut të kredisë

Bordi i Drejtuesve ka deleguar përgjegjësinë për administrimin e rrezikut tek Komiteti i Kredisë së Bankës. Sektori i Rrezikut të Kredisë, që raporton paralelisht tek Drejtori Ekzekutiv, është përgjegjës për mbikqyrjen e rrezikut të kreditit të Bankës. Menaxhimi i rrezikut të kredisë realizohet përmes:

Krijimi i politikave të rrezikut të kredisë në konsultim me nejtë e biznesit, duke mbuluar kërkësat për kolateral, vlerësimin e kredive, klasifikimin dhe raportimin e rrezikut dhe përputhshmërisë me kriteret rregullatore dhe ligjore.

BANKA AMERIKANE E INVESTIMEVE SHA

Shënime të pasqyrave financiare të veçanta më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

(Të gjitha shumat janë në mijë Lekë, përveçse kur shprehet ndryshe)

5. MANAXHIMI I RREZIKUT (VAZHDIM)

(a) Rreziku i kredisë (vazhdim)

Manaxhimi i rrezikut të kredisë (vazhdim)

